



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Inxhinieri Agromjedisi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Mihallaq Qirjo
2. Dr. Genti Kromidha

Korrik/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi, pranë Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë, në UBT, është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe garanton një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit. Prania e Laboratorit Shkencor të Mjedisit, të akredituar për analiza në fushën e tokës dhe ujërave, është një mbështetje serioze për kërkimin shkencor dhe procesin mësimor.

Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësive të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka janë lirisht të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre. Interesimi nga institucioni për kualifikim e vazhdueshëm të personelit është serioz.

Nga takimet e realizuara në institucion me drejtuesit dhe stafin akademik pranohet problemi i mbingarkesës, duke theksuar se rekrutimi i stafit të ri është i vështirë sa kohë nuk është stabilizuar numri i studentëve që hyjnë në programet e studimit të ofruara nga ky institucion.

Në DVV theksohet se qëndrueshmëria financiare është një pikë e dobët. Nga diskutimet me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, u sqarua se kjo lidhet me nevojën për shtimin e stafit dhe reduktimin e ngarkesës, çka garanton përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe më shumë mundësi për kërkim shkencor. Numri jo i stabilizuar i studentëve në ciklet e ndryshme të studimit ndikon në qëndrueshmërinë financiare afatgjatë. Problematikë e vërejtur mbetet financimi i kërkimit shkencor, i cili bazohet kryesisht në mundësitë e krijuara përmes programeve të shkëmbimit apo të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me të tretët.

Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ. Sistemi lejon aksesimin dhe komunikimin nëpërmjet adresave të postës elektronike.

Gjatë takimit me studentët ata theksuan se kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin e UBT dhe komisionet e ndryshme të FBM. Studentët u shprehën se përfaqësuesit e tyre arrijnë të përcjellin informacionin nga lart poshtë dhe shqetësimet e tyre nga poshtë lart. Në UBT funksionojnë edhe Këshillat studentorë. Pranë FBM funksionon edhe Forumi Studentor për Mjedisin dhe Bujqësinë, i cili nxit pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore. Studentët janë përfshirë edhe në programin Erasmus+.

Institucioni duhet të gjejë rrugë shtesë për gjurmimin e studentëve të diplomuar, për të kuptuar në mënyrë më të plotë tendencat e tregut të punës dhe më specifikisht të segmenteve të tregut që përthithin specialistët e dalë nga ky cikël studimi. Njohja më e thelluar e tregut do të ndihmojë edhe në përshtatjen më të mirë të programit të studimit bazuar në kapacitetet dhe burimet që disponon Departamenti i AgroMjedisit dhe Ekologjisë.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i vlerësimit të jashtëm është përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, miratuar nga Bordi i Akreditimit. Ekspertët e përzgjedhur morën pjesë në trajnimin e organizuar nga ASCAL më 03.05.2019 mbi kryerjen e vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit bazuar në standardet e reja të sigurimit të cilësisë. Nëpërmjet sistemit elektronik AMS të ASCAL, ekspertët u njohën me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga Institucioni i Arsimit të Lartë. Në datat 27-28 Maj 2019, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh, intervistash e vëzhgimesh me stafin akademik dhe ndihmës në mjediset e institucionit. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion. Koordinatore Teknike e ASCAL është Zj. Ersi Dako.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Agromjedisi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE “INXHINIERI AGROMJEDISI”

Standardi I.1`	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit të UBT, të vizitës në institucion dhe shqyrtimit të materialit të depozituar (DVV) për akreditimin e këtij programi Master i Shkencave, ky program studimi gjendet në përputhje me interesat kombëtare të vendit, kryesisht në përgatitjen e specialistëve të fushave të zhvillimit të bujqësisë dhe mjedisit. Dokumentacioni mbështetës përbëhet nga Statuti i UBT, Plani strategjik 2016-2023.</p> <p>Ky kriter është referuar qartë në takimet me drejtuesit e institucionit, stafi pedagogjik dhe kërkimor si dhe vetë studentët.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës: Aneks 1: Mendimi i Dekanit Aneks 2.1: Statuti i UBT-së, (Kreu I, Neni I.1 dhe Kreu VII Neni 49)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit i ofruar në Inxhinieri Agromjedisi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit të UBT dhe vizitës në institucion konfirmon se ai është ndërtuar mbi një përvojë të gjatë institucionale, të vlerave akademike dhe ato të kërkimit shkencor. UBT përfaqëson një prej institucioneve akademike me përvojë unike në vend në fushën e bujqësisë dhe me një staf pedagogjik dhe kërkimor të krijuar ndër breza, të cilët vijojnë të kontribuojnë në programin e këtij Masteri Shkencor.</p> <p>Stafi drejtues dhe pedagogët konfirmojnë vijimin e punës së institucionit në këtë program në linjën e vlerave të ndërtuara dhe konsoliduara sikundërse shprehen edhe në dokumentacionin mbështetës të:</p> <p>Aneks 1: Mendimi i Dekanit Aneks 2.1: Statuti i UBT-së, Aneks 5.2: Rregullore e studimeve Universitare Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Programin Master i Shkencave</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Vizita në institucion konfirmon koherencën e qëllimeve dhe misionit të programit të Master i Shkencave me ato të paraqitura në dokumentacionin e paraqitur prej UBT për këtë qëllim.</p> <p>Qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi është në koherencë me atë të institucionit në tërësi “ ... për përgatitjen e specialistëve të fushës së bujqësisë dhe mjedisit ...”.</p>

	<p>Fusha e veprimtarisë së institucionit në tërësi dhe të njësisë bazë që ofron këtë program janë gjetur në përputhje të plotë. Programi konfirmohet të formojë dhe kualifikojë specialistë të fushës së <i>mjedisit dhe të bujqësisë në drejtimet e menaxhimit mjedisor, të burimeve natyrore dhe bujqësisë</i>”.</p> <p>Përputhshmëria e veprimtarisë u vërejt edhe në ndërveprimin horizontal ndërmjet njësive të ndryshme në institucionin e UBT si në fushën e mësimdhënies (shkëmbimi i stafit pedagogjik ndërmjet njësive të ndryshme) dhe në atë të kërkimit shkencor (Laboratori Shkencor i Mjedisit, i akredituar) të lidhur me këtë Master Shkencor.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës i paraqitur në RVB, i konfirmuar dhe gjatë vizitës në institucion:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT</p> <p>Aneks 5.2: Rregullore e studimeve në UBT</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinjeri Agromjedis</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Bazuar në takimet e planifikuara gjatë vizitës në institucionin e UBT-së, dhe veçanërisht në Departamentin e Agromjedisit dhe të Ekologjisë, vërehet se specialistët e formuar në Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedis përrhithen kryesisht nga tregu i punës në nivel kombëtar në fushat e menaxhimit mjedisor, të fokusuar jo vetëm në drejtimin ekonomik të bujqësisë, por edhe në atë të menaxhimit mjedisor të burimeve natyrore. Përvoja shumëvjeçare e UBT dhe gati 20 vjeçare e këtij Departamenti (prej vitit 2001) ka mundësuar të përmbushë nevojat e tregut kombëtar të punës me specialistë të fushës dhe ti përshtatet kërkesave të reja të këtij tregu.</p> <p>Numri i studentëve plotëson kuotat dhe kërkesat në rritje për vijimin e studimeve të nivelit të dytë në këtë Master Shkencor, aktualisht me 60 studentë në dy vitet e studimit, është tregues - i konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin dhe studentët - se tregu i punës arrin të përthithë pjesën më të madhe të studentëve të diplomuar.</p> <p>Vlerësime më të plota të shkallës së përthithjes së tregut dhe kërkesave dinamike të tregut të punës dhe segmenteve specifike të tij për njohuri specifike që duhen marrë gjatë studimeve në këtë program Master Shkencor duhen thelluar më tej prej Zyrës së Karrierës në UBT.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës i shqyrtuar për këtë kriter përbëhet nga:</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT.</p> <p>Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedis.</p> <p>Aneks 16.1: Studim tregu për ciklin e II të studimeve në Master Inxhinieri Agromjedis.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, veçanërisht në Statutin e UBT dhe ndërlidhjen e programeve të studimeve sipas cikleve, vijimi i studimeve në këtë cikël mundëson vijimin më tej të studimeve në ciklin e tretë.</p> <p>Vizita në institucion dhe komunikimi me drejtuesit e institucionit (Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit DAME) konfirmon</p>

	<p>kapacitetet dhe njohuritë në këtë program që mundësojnë vijimin më tej të studimeve në ciklin e tretë si njohuri shkencore apo kapacitete kërkimore shkencore.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës për këtë kriter: Aneks 2.1: Statuti i UBT. Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinjeri Agromjedisi. Aneks 14: Dosja e plotë e programit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur për këtë program, RVB dhe vizita në institucion konfirmon ndjekjen e linjës së përcaktuar në nivel institucional të shprehur deri në objektivat e programit Master i Shkencave.</p> <p>Qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi janë në koherencë me atë të institucionit në tërësi “ ... për përgatitjen e specialistëve të fushës së bujqësisë dhe mjedisit ...”.</p> <p>Fusha e veprimtarisë së institucionit në tërësi dhe në njësinë bazë që ofron këtë program janë gjetur në përputhje të plotë. Programi konfirmohet të formojë dhe kualifikojë specialistë të fushës së mjedisit dhe të bujqësisë në drejtimet e menaxhimit mjedisor, të burimeve natyrore dhe bujqësisë”.</p> <p>Statuti i UBT-së dhe takimet me nivelet drejtuese të institucionit (Dekanin dhe Përgjegjësin e DAME) konfirmojnë se përputhshmëria e veprimtarisë së programit me atë të institucionit në tërësi: formimi i specialistëve të fushës së menaxhimit të mjedisit në bujqësi dhe më gjerë, dhe atë të burimeve natyrore. UBT ka përvojë të gjatë dhe unike në menaxhimin e burimeve natyrore si ato të tokës, pyjeve, burimeve gjenetike të bimëve dhe kafshëve, etj.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës i paraqitur ne RVB, i konfirmuar dhe gjatë vizitës në terren: Aneks 2.1: Statuti i UBT Aneks 5.2: Rregullore e studimeve në UBT Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstron se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, kryesisht të Planit strategjik të UBT 2016-2023 dhe rregullores së institucionit, sikundërse edhe shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konçize në RVB, dokumentet drejtuese të politikës së UBT-së (statuti dhe rregullorja) shërbejnë si bazë drejtimi</p>

	<p>edhe në ndërtimin dhe funksionimin e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi.</p> <p>Dokumentacioni i këtij programi (Rregullorja e programit dhe Plani mësimor) janë gjetur në zbatim dhe në përputhje me dokumentacionin bazë të institucionit të UBT-së.</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT Aneks 5.2: Rregullore e studimeve në UBT Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Sikundërse referohet në RVB dhe është konfirmuar në takimet në institucion, Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi synon <i>“përgatitjen e specialistëve dhe shkencëtarëve në fushën e mjedisit me dije dhe kompetenca profesionale në përputhje me zhvillimet e sotme mjedisore të jenë të aftë për të kontribuar në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në Shqipëri”</i>.</p> <p>Ky objektivi gjendet në përputhje me qëllimin e vetë institucionit të UBT-së shprehur në dokumentat kryesore të politikës dhe drejtimit të tij. Emërtimi i programit është në përputhje me fokusin e institucionit (referencë “Bujqësia”) dhe të njësisë bazë (referencë Departamenti DAME). Organizimi i studimeve është në përputhje me ciklet e studimit dhe ndjek ciklin e parë të studimeve në këtë fushë (Bachelor) dhe programi përbëhet nga elementët e nevojshëm teorikë dhe praktikë të formimit të specialistit Inxhinier i Agromjedisit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikuar gjatë vizitës në terren: Aneks 2.1: Statuti i UBT Aneks 3.1: Plani strategjik i UBT 2016-2025 Aneks 5.2: Rregullore e studimeve në UBT Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet gjatë vizitës në Departamentin e Agromjedisit dhe të Ekologjisë (DAME), u konfirmua referimi në RVB se programi Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi ka synuar të ndjekë tendencën globale dhe atë kombëtare të rritjes së interesit dhe shfrytëzimit të mundësive në fushën e menaxhimit mjedisor të bujqësisë dhe të burimeve natyrore.</p> <p>Ky zgjerim i fokusit drejt përfshirjes së DAME me një program Masteri Shkencor u shpreh nga drejtuesit dhe stafi pedagogjik si kërkesë e tregut, rrjedhur prej nevojave të vendit për një menaxhim më të drejtë dhe më të monitoruar mjedisor. Numri i programeve të shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve (Erasmus dhe programe të tjera) me universitete të ndryshme jashtë vendit gjatë tre viteve të fundit konfirmon ecurinë në përputhje me trendet globale.</p> <p>Dokumentacioni mbështetës i shqyrtuar për këtë kriter përbëhet nga: Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi.</p>

	Aneks 16.1: Studim tregu për ciklin e II të studimeve në Master Shkencor Inxhinieri Agromjedisi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>Sikundërse shprehet edhe në RVB, programi Master Shkencor në Inxhinieri Agromjedisi ka objektiva të qarta për formimin e studentëve lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njohuritë e nevojshme në fushën e Agromjedisit;</i> - <i>Përgatitjen praktike të specialistëve ... në fushën e menaxhimit të mjedisit.</i> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimi me stafin e DAME solli në vëmendjen e ekspertëve të vlerësimit objektivin kryesor të programit që ishte formimi i specialistëve në fushën e menaxhimit mjedisor, me fokus te burimet natyrore dhe bujqësinë. Ky drejtim kryesor konfirmon përputhjen e formimit të studentëve me profilin e programit.</p> <p>Dokumentacioni i referuar në RVB dhe konfirmuar prej ekspertëve: Aneks 5.1: Rregullorja e UBT Aneks 6.1: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 7.1: Rregullore e studimeve në Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p>
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej institucionit dhe vizitës në terren u shqyrtua dhe vlerësua organizimi dhe shkalla e gjurmimit të studentëve të diplomuar të absorbuar në tregun e punës. UBT ka ngritur dhe ka funksionale Degën e Informimit, të Orientimit dhe të Karrierës së Studentëve e cila ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA) me specialistë të dedikuar për të ndjekur ecurinë e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Sikundërse referohet edhe në RVB, institucioni kryen një sërë veprimtarish me qëllim lidhjen e studentëve me tregun e punës dhe referimin në program të kërkesave të këtij tregu me qëllim lidhjen më të plotë të studentëve të diplomuar me mundësitë e punësimit.</p> <p>Institucioni organizon çdo vit Panairin e punës – në nivel universiteti, me pjesëmarrjen e kompanive dhe firmave të ndryshme. Studentët plotësojnë formularë interesi dhe kompanitë private pjesëmarrëse prezantojnë mundësitë e tyre të punësimit. Sipas referimit të stafit drejtues dhe QKA, në fushën e agromjedisit tregu i punës për studentët e diplomuar përbëhet nga institucione qendrore dhe vendore (njësitë përgjegjëse për menaxhimin mjedisor), kompani të ndryshme. Numri i studentëve të</p>

	<p>punësuar është 1-2 studentë për çdo kompani. Referohet se interesi i kompanive ka ardhur në rritje. QKA ndihmon studentët në plotësimin e dokumentacionit për punësim dhe pjesëmarrje në panairë të ndryshme. QKA ka gjurmuar studentët e diplomuar, por niveli i përgjigjeve të kthyer mbetet i ulët, që bën të vështirë një vlerësim të plotë dhe të saktë të segmenteve të tregut të punës të cilat përthithin studentët e diplomuar në Masterin Shkencor Inxhinieri Agromjedisi. Përmirësimi i nivelit të gjurmueshmërisë duke rritur shkallën e informacionit të grumbulluar do të ndihmojë në lidhjen më të plotë me tregun e punës.</p> <p>Ndërkohë DAME ka paraqitur dhe referuar një listë bashkëpunimesh me institucione brenda vendit ku mundësohet kryerja e praktikës profesionale, që në shumë raste shërben edhe si periudhë prezantimi/prove për punësimin e mëvonshëm të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion: Aneks 12.3: Vendim senati për QKA Aneks 17.1: Studim i tregut të punës Aneks 29; Të dhëna tabelare për punësimin e studentëve Aneks 32.1 dhe 32.6: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e programit mësimor Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi synojnë formimin e specialistëve të ardhshëm të menaxhimit të mjedisit në fushën e agromjedisit me dije dhe aftësi profesionale që i përgjigjen nevojave të tregut dhe tendencave të vendit dhe ato ndërkombëtare në këtë drejtim. Ato shprehen jo vetëm në dokumentat kryesore të programit (Rregullore e programit të studimeve) por edhe në Planin mësimor të programit.</p> <p>Ndryshimet e referuara edhe në RVB të ndodhura në program gjatë viteve 2014 dhe 2017, të konfirmuara edhe gjatë takimit me stafin pedagogjik të këtij programi mësimor, kanë synuar të përafrojnë kërkesat e tregut të punës në dije të nevojshme në këtë fushë studimi duke përfshirë lëndë apo tematika të reja që mundësojnë punësimin e studentëve në një gamë të gjerë institucionesh dhe kompanish private.</p> <p>Studentët përfaqësues gjatë takimit në institucion kanë referuar se e shohin këtë program studimi me interes për arsye se krijon mundësi punësimi në tipologji të ndryshme punëdhënësish.</p> <p>Tendenca për të kapur segmente më të gjera në tregun e punësimit kërkon gjetjen e një balance më të kujdesshme lidhur me thellësinë e njohurive të marra në lëndë specifike, pra me formimin e një specialisti të plotë për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara në drejtime të ndryshme të tregut të punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion: Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Inxhinieri Agromjedisi Aneks 17.1: Studim periodik i tregut të punës Aneks 19: Syllabuse të lëndëve</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, dhe referimin e bërë në RVB, struktura e programit e bazuar në kreditet ECTS ka mundësuar lëvizjen e studentëve në programe të ngjashme jashtë vendit.</p> <p>Studentët e takuar gjatë vizitës në institucion kanë referuar se i njohin dhe janë prezantuar me mundësitë e shkëmbimit me institucione akademike jashtë vendit, kryesisht lëvizje në kuadër të programit ERASMUS. Numri i studentëve që kanë përfituar nga mundësuar për vizituar (mobiliteti/shkëmbimi me universitete jashtë vendit) në nivelin Master Shkencor është ende i ulët (krahasuar me interesin dhe shkëmbimin e ndodhur në programin Bachelor).</p> <p>Rritja e shkëmbimit në Programin Master Shkencor do të ndihmonte edhe më shumë studentët në zgjerimin e njohurive të lidhura me kërkimin shkencor dhe të kompetencave konkrete në drejtime specifike të formimit të tyre si specialistë të menaxhimit mjedisor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion: Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Aneks 15.3: Suplementi i diplomës Aneks 19: Syllabuset e lëndëve ndër vite</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB, programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Argomjedisi është hartuar mbi bazën e shkëmbimeve me programe dhe legjislacionin e BE-së. Formatit dhe organizimi është në linjë me standardet e Bolonjës, ndërkohë që programi mësimor është në ndryshim të vazhdueshëm.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi pedagogjik ka referuar shkëmbime me institucione të huaja evropiane që kanë ndihmuar në hartimin e programit në tërësi dhe të lëndëve të veçanta.</p> <p>Aneks 19: Syllabuset e lëndëve ndër vite</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur (Plani mësimor) dhe vizita në institucion kanë konfirmuar se programi përmban praktikën profesionale në periudhë 4-5 javore në fund të vitit të dytë.</p> <p>Ndërkohë DAME ka paraqitur dhe referuar një listë bashkëpunimesh me institucione brenda vendit ku mundësohet kryerja e praktikës profesionale.</p> <p>Ndonëse specialisti Inxhinier i Agromjedisit nuk është ende profesion i rregulluar, drejtime të tij si “Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis” është i çertifikuar dhe studentët e diplomuar mund të përfitojnë prej tij.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe vlerësuar gjatë vizitës në institucion: Aneks 5.1: Rregulloja e studimeve në UBT Aneks 32.1 dhe 32.6: Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen</p>	<p>Referuar në RVB dhe konfirmuar gjatë vizitës në institucion, module të caktuara jepen/mund të jepen në gjuhën Angleze për të mundësuar shkëmbimin e studentëve të huaj. Në vitet e fundit janë referuar një numër rastesh shkëmbimi të studentëve të huaj, kryesisht Italia, ndonëse numri mbetet i ulët. Institucioni ka kryer një sërë konferencash ndërkombëtare</p>

e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	(shembull konferencat shkencore çdo dy vjet me Universitetin e Jenës, Gjermani, Konferenca për tokën) në të cilat ka pasur kërkues dhe studentë të huaj që kanë vizituar institucionin dhe marrë pjesë në referime dhe kumtime të përbashkëta shkencore.			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi ka vënë në dispozicion të gjithë syllabuset në Shqip dhe Anglisht. Gjatë vizitës në institucion ky dokumentacion është mundësuar qoftë në formë të shtypur ashtu edhe përmes faqes së internetit të DAME Dokumentacioni i referuar: Aneks 19.7: Syllabuset e lëndëve në Anglisht Aneks 14: Dosja e plotë e programit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Përshkrimi në RVB, vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit të bollshëm japin një pamje të plotë të kapaciteteve dhe burimeve të institucionit për të ofruar dhe menaxhuar një program të tillë studimi. DAME, si departament i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) është krijuar në vitin 2001, dhe ka në përbërje të tij një personel mësimor, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi. Në përbërje të stafit janë 22 personel akademik efektiv (PAE), 12 personel akademik me kontratë (PAK) dhe 10 punonjës mbështetës dhe administrativ (PA). Stafi PAE paraqitet me kualifikimin 13 Prof., 2 Prof. As., 4 Dr dhe 3 MSc. Shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit, më së shumti në universitete perëndimore dhe ka një numër të lartë botimesh shkencore (62 artikuj shkencorë dhe 58 referime/kumtesa shkencore) në revista brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Përbërja moshore e stafit akademik është e balancuar duke pasur grupmosha të ndryshme që mundësojnë përçimin e përvojës dhe kualifikimit brenda njësisë.</p> <p>Përvoja 19 vjeçare e DAME ka mundësuar ri-orientimin dhe kualifikimin e stafit në drejtime të cilat përmbahen në program, kryesisht në fushat më të reja të menaxhimit mjedisor. Në këtë mënyrë, stafi akademik ka përmirësuar programet mësimore herë pas here. Numri i të diplomuarve të referuar është i lartë rreth 500 MSc dhe 30 Doktoratura.</p> <p>Gjatë takimit me stafit pedagogjik, në vizitën në institucion, stafi ka referuar mbingarkesë mësimore, prej numrit të shtuar të studentëve, mbingarkesa mësimore vlerësohet e menaxhueshme dhe brenda normave</p>

	<p>të përcaktuara nga MASR për orët e lejuara mbi normë. Stafit vlerëson se ulja e numrit të studentëve në vitet e ardhshme do të mundësojë ndjekjen më të mirë të punës së studentëve, sidomos gjatë kryerjes së praktikave profesionale, në laboratore apo realizimin e temave të diplomës.</p> <p>Shqyrtimi i dokumenteve të referuara përmban: Aneks 2.4: Organograma e FBM Aneks 11.8: Personel akademik dhe ndihmes akademik UBT Aneks 25: Të dhëna mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik Aneks 43.1: Të dhëna për kërkimin në DAME</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe referimi prej takimeve gjatë vizitës në Institucion konfirmojnë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Inxhinieri Agromjedisi janë në përputhje me drejtimin e njësisë kryesore qoftë në nivel Fakulteti të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe atë të Departamentit DAME.</p> <p>Kjo përputhshmëri shprehet në rregulloret e njësisë bazë në zbatim të VKM 531 dt 11.9.2018. Ajo shprehet qartë në emërtimin e programit të studimit, i cili është në koherencë me atë të njësisë bazë DAME.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Dokumentacioni i referuar për shqyrtim: Aneks 6.1: Rregullore e FBM Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Aneks 31: VKM 531 dt 11.9.2018</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Shqyrtimi i një sërë dokumentesh të paraqitura prej Institucionit lidhur me marrëdhëniet brenda-institucionale me njësi të tjera bazë, si dhe vizita në institucion (takimi me stafin akademik, përgjegjës të departamentit DAME) konfirmoi se programi mësimor realizohet kryesisht me mbulimin e personelit akademik të vetë njësisë bazë (DAME).</p> <p>Për nevoja specifike të mësimdhënies, ndërveprimi me njësi të tjera brenda FBM është i shprehur në procesin mësimor dhe elementë të kërkimit shkencor/kryerjes së diplomave. Gjatë takimit me stafin</p>

	<p>akademik, morën pjesë të paktën tre pedagogë të njërive të tjera që kontribuonin në procesin mësimor/kërkimor të programit Master Shkencor në Inxhinieri Agromjedi.</p> <p>Siç shprehet edhe në RVB dhe referohet në dokumentin e analizës vjetore të DAME, vlerësimi i performancës kryhet për të gjithë stafin që merr pjesë në realizimin e objektivave të programit Master i Shkencave.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneks 6.1: Rregullore e FBM Aneks 7.1: Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave Aneks 14: Dosja e programit Aneks 38.2: Analize vjetore e DAME</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Siç është referuar në RVB dhe në takimin e Dekanin e FBM dhe Përgjegjës të Departamentit DAME, njësi bazë ka një sërë bashkëpunimesh me institucionet kombëtare përfshirë këtu Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjenci të ndryshme shtetërore dhe një sërë kompanish private. Bashkëpunimi institucional është i shprehur dhe rregulluar kryesisht përmes Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndër-institucional me qëllim shkëmbimin e specialistëve dhe studentëve për qëllime të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur referohen 44 bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit kryesisht në përmbushjen e detyrimit të praktikës profesionale të studentëve. Sikundërse është referuar gjatë takimeve disa prej këtyre marrëveshjeve rinovohen çdo vit në varësi të nevojës së institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe konfirmuar gjatë takimeve në institucion: Aneks 7.1: Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave Aneks 32.1 dhe Aneks 32.6: Tabelë e bashkëpunimeve institucionale Aneks 34: Marrëveshjet aktive të bashkëpunimit</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Zbatimi i praktikave profesionale është vlerësuar si nga studentët ashtu edhe nga stafi pedagogjik i DAME, gjatë vizitës në institucion, si një ndër komponentet e rëndësishme të procesit mësimor (e realizuar në vitin e II-të, semestri i II-të). Ato kryhen në institucione apo kompani private mbi bazën e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit. Institucioni referon 44 Marrëveshje Bashkëpunimi me institucione homologe dhe institucione të tjera që punojnë në fushën e veprimtarisë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Një pedagog caktohet përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të praktikës profesionale. Futja në bashkëveprim me një institucion/kompani formalizohet mbi bazën e marrëveshjeve standarde. Progresi i punës së studentit monitorohet nga institucioni pritës dhe fakulteti. Në fund studentit paraqet një relacion dhe prezanton detyrat e kryera/të përmbushura.</p> <p>Realizimi i praktikës profesionale në këtë format ka përparësi të përfshirjes së një game të gjerë institucionesh e kompanish, që krijojnë një bazë të mirë përzgjedhëse për studentin. Nga ana tjetër, realizimi individual paraqet vështirësi për ndjekjen dhe monitorimin e vazhduar të</p>

	<p>procesit të zbatimit prej pedagogut mbikqyrës. Kjo mënyrë mund të krijojë vështirësi lidhur me efektivitetin e zbatimit të praktikës në terren.</p> <p>Aneks 32.1 dhe Aneks 32.6: Tabelë e bashkëpunimeve institucionale Aneks 34: Marrvëshjet aktive të bashkëpunimit</p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB dhe vlerësuar në takimin me pedagogët gjatë vizitës në Institucion, departamenti ka kryer vlerësime mbi bazë vjetore të ecurisë së punës gjatë praktikës, si procesi i vlerësimit të përgjithshëm të programit, duke mundësuar rivlerësimin e bashkëpunimeve të deritanishme. Stafi pedagogjik ka paraqitur se vijimi i bashkëpunimeve është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili bazohet edhe në interesin e institucioneve dhe sidomos të kompanive private në punësimin e studentëve më të aftë pranë tyre.</p> <p>Aneks 38: Analizë e punës së DAME</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UBT, me strukturën e saj të Fakulteteve dhe Departamenteve, pjesë e së cilës është edhe FBM dhe DAME referojnë në RVB dhe përmes takimeve gjatë vizitës në institucion se mbështesin dhe promovojnë botimin dhe promovimin e kërkimit shkencor në kuadër të institucionit.</p> <p>Gjatë tre viteve të fundit, FBM ku kontribon edhe DAME kanë organizuar (ose kanë qenë pjesëmarrës/kontribues) në tre konferenca shkencore, ndërmjet të cilave një për Mbrojtjen e Tokës, dhe një për Bioteknologjinë dhe Mjedisin në bashkëpunim në Universitetin e Jenës, Gjermani.</p> <p>Punimet shkencore të stafit mesimor-kërkimor dhe studentëve botohen në AJAS (revistën shkencore të UBT www.ajas.ubt.edu.al) si dhe në revista shkencore të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Gjatë takimit me stafin e programit referuan vështirësi financiare lidhur me botimin në revista me faktor impakti. Mbështetja e institucionit në këtë drejtim u artikulua nga stafi si një ndihmesë për rritjen e mundësive të promovimit më tej.</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT Aneks 20: CV të stafit akademik të DAME</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u referua në disa nivele që vlerësimi i performancës së kërkimit shkencor realizohet në nivelin e grupeve kërkimore, të Departamentit, të Fakultetit dhe në nivelin e UBT prej njësisë së Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve.</p>

	<p>Vlerësimi i realizimit të objektivave shkencore bëhet një herë në vit, rezultatet e së cilës përmbledhen në raportin e analizës vjetore të punës kërkimore shkencore në nivel institucioni.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar, dhe informacion shtesë i grumbulluar gjatë takimeve në nivel institucioni: Aneks 38.2. Analizë vjetore e departamentit</p>			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Ngjashëm me Kriterin 1 (Standardi I.6) rrugët e ndjekura janë Konferencat shkencore dhe botimi në revistën shkencore të institucionit AJAS: www.ajas.ubt.edu.al (për më shumë informacion referoju Kriterit 1)</p>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	<p>Në RVB përshkruhet se institucioni merr masat e duhura për të mbrojtur pronësinë intelektuale në të gjithë botimet dhe punimet shkencore duke ndjekur parimet e rregullores së Etikës së UBT-së. Gjatë takimeve në institucion nuk është referuar ndonjë rast i veçantë problematikës lidhur me këtë çështje as nga stafi akademik dhe as prej drejtuesve të institucionit.</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT-së Aneks 6.3: Rregullore e Etikës së UBT-së Aneks 6.7: Rregullore për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale</p>			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	<p>Gjatë takimeve në vizitën në institucion, është referuar përfshirja e studiuesve të rinj dhe studentëve në kërkimin shkencor. Disa nga rrugët e përfshirjes janë programimi i përfshirjes së grupeve të studentëve në punë konkrete pranë Laboratorit Shkencor të Mjedisit, i akreditur, për një periudhë tre javore, ku studentët kryejnë punët e tyre gjatë kryerjes së diplomës, ose studiuesit e rinj realizojnë kërkimin shkencor. Gjatë takimit me stafin akademik u referua problematika e mungesës së një fondi të veçantë për kërkimin shkencor, që pamundëson avancimin e shpejtë apo hapjen e fushave të reja të kërkimit shkencor. Një pjesë të mirë të këtij boshllëku të krijuar, personeli akademik dhe më së shumti studiuesit e rinj, e përmbushin duke u futur në programe të ndryshme shkëmbimi në universitetet jashtë vendit.</p> <p>Aneks 3.1: Plani strategjik i UBTsë 2016 -2025</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me organizimin e programit të studimit si dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, programi Master i Shkencave është i organizuar në lëndë dhe module. Çdo lëndë është e vlerësuar me kredite në bazë të ngarkesës në orë mësimore dhe orë pune individuale të studentit. Programi mësimor përmban 120 kredite të ndara në dy vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose 30 kredite për çdo semestër). Kjo mënyrë organizimi është në përputhje me VKM 41 dt 24.1.2018.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneks 5: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit Aneks 19: VKM 41 dt 24.1.2018</p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	<p>Shqyrtimi i Programit të studimit dhe Kurrikulës së lëndëve, e diskutuar edhe në takimin me stafin e DAME dhe studentët e Masterit Shkencor, paraqet një larmishmëri lëndësh që mbulojnë fusha të përgjithshme të menaxhimit mjedisor, legjislacionit, studimit të burimeve natyrore si dhe fusha specifike të ndotjes dhe monitorimit të komponenteve mjedisore si tokë, ujë dhe ndotësve të veçantë. Kjo mundëson mbulimin e fushave të ndryshme të specialiteteve të menaxhimit të mjedisit duke krijuar mundësi punësimi në disa drejtime apo institucione.</p> <p>Gjatë takimeve edhe me drejtuesit e njësisë dhe pedagogët e lëndëve u shpreh qartë interesi për të pasur një mbulim sa më të gjerë, i cili arrihet përmes ndërtimit dhe përfshirjes së lëndëve të formimit karakterizues, por me aplikime konkrete në drejtime të ndryshme. Përfshirja e punëve laboratorike apo edhe vizitave në terren (praktika mësimore) studentët orientohen drejt një tregu të gjerë punësh.</p> <p>Ndër dokumentet e shqyrtuara më të rëndësishme për të vlerësuar këtë kriter është: Aneks 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit</p>
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi përmban disa lëndë, të cilat vlerësohen të jenë thellim i njohurive të marra gjatë studimeve në programin e ciklit të parë Bachelor. Studentët e takuar gjatë vizitës në institucion, si edhe pedagogët e lëndëve në këtë program konfirmuan se Masteri i Shkencave është strukturuar në konceptin e thellimit të njohurive duke futur mendimin kritik lidhur me zgjidhjen e problemeve shkencore dhe praktike në fusha të menaxhimit mjedisor të ekosistemeve bujqësore dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të praktikave bujqësore. Një numër lëndësh me zgjedhje plotësojnë këtë</p>
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi përmban disa lëndë, të cilat vlerësohen të jenë thellim i njohurive të marra gjatë studimeve në programin e ciklit të parë Bachelor. Studentët e takuar gjatë vizitës në institucion, si edhe pedagogët e lëndëve në këtë program konfirmuan se Masteri i Shkencave është strukturuar në konceptin e thellimit të njohurive duke futur mendimin kritik lidhur me zgjidhjen e problemeve shkencore dhe praktike në fusha të menaxhimit mjedisor të ekosistemeve bujqësore dhe minimizimin e ndikimit mjedisor të praktikave bujqësore. Një numër lëndësh me zgjedhje plotësojnë këtë</p>

<p>fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>formim dhe i japin programit një karakter dinamik dhe bashkëkohor. Sikundërse shprehet edhe në RVB, por e konfirmuar edhe nga pedagogët e këtij programi studimi, përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e novatore.</p> <p>Ndër dokumentet e shqyrtuara më të rëndësishme për të vlerësuar këtë kriter është:</p> <p>Aneksi 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sikurse përmendet edhe në vlerësimin lidhur me Kriterin 1 të këtij standardi, programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisori është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore të një programi studimi të ciklit të dytë.</p> <p>Ai përmban të gjithë elementët teorikë, praktikë dhe të vlerësimit, të punës në auditor apo të pavarur.</p> <p>Aneks 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit Aneks 19: VKM 41 dt 24.1.2018</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në shtesë të vlerësimit për Kriterin 1 të këtij standardi, studenti ka të planifikuar në programin e studimit një semestër të veçantë (Semestri i dytë , viti i dytë) i vlerësuar me 30 kredite, ku studenti ka të përcaktuar kohën e nevojshme për tu marrë me hartimin e temës së diplomës, përfshirë punën kërkimore dhe shkencore për këtë element të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Puna kërkimore është individuale dhe vlerësimi i punëve bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur në nivelin e njësisë bazë. Studenti drejtohet nga një pedagog i programit, i cili drejton kërkimin shkencor.</p> <p>Pjesa më e madhe e tematikave përmban punë praktike në laborator, por një numër temash janë edhe të karakterit përshkruar/analizues. Në çdo rast, ngarkesa për pedagogët në drejtimin e temave të diplomës është vlerësuar e menaxhueshme me 1-2 studentë për çdo pedagog.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe verifikimin gjatë vizitës në institucion, Departamenti DAME, është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit. Ai është strukturë në përbërje të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit.</p> <p>Ky institucion e ka kaluar procesin e akreditimit institucional sipas ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (2015). Detyrimet në nivelin e FBM kanë të bëjnë me hartimin e politikave dhe sigurimin e cilësisë, të cilat shprehen në Rregulloren e FBM 2017-2018.</p>

	<p>Njësia e sigurimit të cilësisë që vepron në nivel të UBT-së garanton cilësinë në procesin mësimor.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe shqyrtimit të tij gjatë vizitës në terren lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e saj, GVJ vërtetojnë se njësia bazë i plotëson kushtet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore e studimit në DAME</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur sipas RVB dhe vizita në institucion konfirmojnë strukturën organizative dhe funksionale të njësisë bazë. FBM drejtohet nga Dekani dhe DAME nga përgjegjësi i departamentit, të cilët janë të zgjedhur dhe kryejnë funksionet e përcaktuara me ligj.</p> <p>Në kuadër të detyrave të përcaktuara është hartimi i rregulloreve lidhur me programin, përcaktimin e mënyrës së organizimit, përcaktimin e stafit mësimor dhe mbështetës, etj.</p> <p>Kjo strukturë e njësisë bazë mundëson edhe monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të programit të studimit si në aspektin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor. Ky monitorim është i paraqitur në dokumentacionin e analizës vjetore të punës të bashkëlidhur në dokumentacionin e depozituar. Kryerja e një procesi të tillë në të gjithë strukturën e UBT dhe deri në njësinë bazë përgjegjëse për realizimin e programit është konfirmuar edhe gjatë takimeve me drejtuesit e njësisë bazë dhe stafin e departamentit.</p> <p>Aneks 2: Statuti i UBT-së Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore e studimit në DAME Aneks 36: Vendimi për emërimin e kordinatorit të programit të studimit</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur dhe RVB shprehin se njësia bazë përmbush detyrimet lidhur me personelin akademik dhe kualifikim e tij.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Dekani i FBM dhe përgjegjësi i DAME kanë konfirmuar vlerësimin institucional të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj për organizimin e programit mësimor përfshirë dokumentacionin në nivel universiteti UBT, Fakulteti (FBM) dhe DAME.</p> <p>Në kuadrin akademik DAME, i krijuar në 2001 si departament i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM), përbëhet nga një personel mësimor, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi. Në përbërje të stafit janë 22 personel akademik efektiv (PAE) dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK). Personeli akademik efektiv paraqitet me kualifikimin 13 Prof., 2 Prof. As., 4 Dr., dhe 3 Msc., ndërsa personeli akademik me kontratë paraqitet me kualifikimin 4 Dr., dhe 8 Msc.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shqyrtimi i CV të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit. Personeli përbëhet nga staf me kohë të plotë.</p>

	<p>Dokumentacioni përmban statutin e universitetit, rregulloret e funksionit institucional dhe ato të lidhura me programin janë të hartuara dhe gjenden të afishuara në faqen e internetit të njësisë bazë.</p> <p>Aneks 2: Statuti i UBT-së Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore studimi në DAME MSc Aneks 11.8: Personel akademik dhe ndihmës akademik UBT</p>				
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Njësia bazë përmbush edhe kriterin e angazhimit të stafit akademik ndihmës dhe atij mbështetës.</p> <p>DAME përmban në strukturën e tij 10 punonjës mbështetës dhe administrativ (PA). Ata janë të përfshirë kryesisht si mbështetës të laboratorëve, por ndihmojnë edhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor (kujdesin për sallat, pajisjet, dokumentacionin, etj.) Dy prej tyre kanë tituj dhe grada dhe janë të përfshirë në drejtimin e Laboratorit Shkencor të Mjedisit. Personeli ndihmës përbëhet nga staf me kohë të plotë.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit të studimit Aneks 20: CV të stafit të DAME Aneks 24.2: Të dhëna për stafin e programit</p>				
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Si pjesë e organizimit brenda DAME funksionojnë tre grupe kërkimore shkencore të cilët ndihmojnë kontribuojnë në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisit.</p> <p>Sipas Aneksit 36 të dokumentacionit të paraqitur për vendimin për emërimin e koordinatorit të programit të studimit, detyrat e tij përfshijnë aspekte organizative dhe koordinuese të procesit mësimor dhe kërkimor. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e GVJ janë takuar dhe kanë diskutuar me koordinatorin e programit të studimit mbi kuadrin e detyrave dhe ecurinë e programit.</p> <p>Aneks 25.2: Plani i ngarkesës mësimore të programit të studimit Aneks 36: Vendim për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</p>				
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Sikundërse referohet në RVB, dhe e vlerësuar gjatë takimeve në institucion, procesi i vlerësimit të ecurisë së punës është vjetor dhe kryhet prej Përgjegjës të Departamentit DAME për të gjitha aspektet e performancës në procesin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor të lidhur me programin.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit paraqiten me shkrim në analizën vjetore dhe raportohen në mbledhjen e departamentit DAME dhe Dekanit të FBM. Ky proces gjendet i shprehur në dokumentacionin bazë të njësisë përgjegjëse për programin dhe në raportet e analizës vjetore.</p> <p>Aneks 2: Statuti i UBT-së Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore studimi në DAME MSc Aneks 38.2: Analizë vjetore e departamentit</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="579 1975 762 2040">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="762 1975 999 2040">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="999 1975 1235 2040">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1235 1975 1469 2040">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				✓
--	--	--	--	---

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Sikundërse referohet në RVB dhe e vlerësuar gjatë takimeve në institucion, DAME është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ajo propozon stukturën dhe ndryshimet në planin mësimor, kurrikulën dhe stafin e përfshirë.</p> <p>Procesi i rishikimit të programit të studimit dhe ndryshimeve realizohet çdo vit, dhe në bazë të nevojës propozohen ndryshime, ose jo. Përgjegjësi i Departamentit DAME është titullari që i propozon drejtuesve rishikimin e programit.</p> <p>Dokumentacioni përmban rregulloret e organizimit të programit të studimit, Planin mësimor, Syllabuset e lëndëve dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore në stafin akademik të përfshirë. I gjithë dokumentacioni i lidhur me programin gjendet në departament dhe disa prej tyre gjenden të afishuara në faqen e internetit të njësisë bazë.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur dhe RVB shprehen se njësia bazë përmbush detyrimet lidhur me personelin akademik dhe kualifikim e tij.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Dekani i FBM dhe përgjegjësi i DAME kanë konfirmuar vlerësimin institucional të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj për organizimin e programit mësimor përfshirë dokumentacionin në nivel universiteti UBT, Fakulteti (FBM) dhe DAME.</p> <p>Aneks 2 : Statuti i UBT-së Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore studimi në DAME MSc Aneks 14: Dosje e plotë e programit të studimit</p>
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur lidhur me organizimin e programit të studimit, si dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, programi i Masterit Shkencor është i organizuar në lëndë dhe module.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi përmban disa lëndë, të cilat vlerësohen të jenë thellim i njohurive të marra gjatë studimeve në programin e ciklit të parë Bachelor.</p> <p>Një numër lëndësh me zgjedhje plotësojnë këtë formim dhe i japin programit një karakter dinamik dhe bashkëkohor.</p> <p>Aneks 14: Dosje e plotë e programit të studimit Aneks 25.2: Ngarkesa mësimore e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi</p>
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit	<p>Çdo lëndë është e vlerësuar me kredite në bazë të ngarkesës në orë mësimore dhe orë pune individuale të studentit. Programi mësimor përmban 120 kredite të ndarë në dy vite mësimore, me dy semestra në çdo</p>

<p>vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose 30 kredite për çdo semestër).</p> <p>Kjo mënyrë organizimi është në përputhje me VKM 41 dt 24.1.2018. Studenti ka të planifikuar në programin e studimit një semestër të veçantë (viti i dytë, semestri i dytë) i vlerësuar me 30 kredite, ku studentit ka të përcaktuar kohën e nevojshme për tu marrë me hartimin e temës së diplomës, përfshirë punën kërkimore dhe shkencore për këtë element të programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar: Aneks 5: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 14: Programet mësimore dhe Kurrikula e programit</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Shqyrtimi i Dosjes së plotë të programit që përmban Planin mësimor dhe Kurrikulën e plotë me sylabuset e lëndëve përmban të gjithë informacionin e nevojshëm të përcaktuar sipas ligjit lidhur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> Lëndët sipas viteve dhe çdo semestër me kreditet përkatëse; Ngarkesën e orëve në auditor si leksione, seminare dhe laboratore; Praktikat mësimore dhe/ose profesionale, në varësi të lëndëve apo semestrit të përcaktuar në planin mësimor; Mënyrën e vlerësimit të çdo lëndë: provim dhe mënyrës së realizimit të tij, vlerësim i vazhduar etj. <p>Bazuar në takimet me stafin dhe studentët e këtij programi gjatë vizitës në institucion është marrë informacioni se studentit njihet me programin dhe mënyrën e vlerësimit përmes dokumentacionit të afishuar në faqen e internetit, njohjes së tij në fillim të vitit prej pedagogëve të lëndëve apo edhe përmes sekretarisë mësimore.</p> <p>Dokumentacioni lidhur me këtë kriter vlerësohet i plotë dhe i mjaftueshëm për studentin Ky fakt është konfirmuar edhe prej studentëve të takuar, të cilët kanë vlerësuar pa probleme këtë pjesë të njohjes së programit të ofruar nga institucioni.</p> <p>Vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar dhe atë në provim. Tendencë është rritja e peshës së vlerësimit gjatë procesit mësimor që varion nga 30%-40%. Për të siguruar një nivel më të lartë të përfshirjes së studentëve dhe cilësi më të mirë, stafi akademik ka vënë në dukje tendencën e rritjes së mëtejshme të kësaj peshë drejt 50%.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit Aneks 25: Ngarkesa mësimore e stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit në programin e studimit paraqiten në Rregulloren e studimeve MSc të DAME si edhe atë të FBM. Programet dhe rregulloret janë të publikuara në faqen e internetit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion është konfirmuar se kriteret e pranimit bazohen në notën mesatare të arritur në ciklin e parë. Gjatë procesit të verifikimit në institucion janë vërejtur raste të transferimit të studentëve në këtë cikël</p>

	<p>të dytë studimi dhe nga programe të tjera studimi kryesisht brenda UBT-së.</p> <p>Aneks 5: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6: Rregullorja e studimeve në FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore e studimit në DAME MSc Aneks 51: Politika e marketingut të programit të studimit</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarist apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur për këtë program studimi përmban në mënyrë të detajuar të gjithë syllabuset e lëndëve në Shqip dhe Anglisht, për të gjithë elementët mësimorë të programit.</p> <p>Standardi i miratuar është ai i të gjithë UBT-së me të gjithë elementët përshkruar të lëndës, pedagogut titullar, vitin dhe semestrin, informacioni i detajuar i përmbajtjes së lëndës, literaturës bazë dhe ndihmëse (në shqip dhe gjuhë të huaj), rezultatet e të nxënësve, konceptet bazë, etj.</p> <p>Dosja e programit është e plotë dhe përmban të gjithë syllabuset e lëndëve të programit.</p> <p>Të gjitha syllabuset miratohen çdo vit, pas kalimit të procesit të rishikimit (nëse ka të tillë) dhe miratohen nga titullari i njësisë bazë, DAME.</p> <p>Programi i studimit mund të ofrohet studentëve në formë të shtypur, bazuar në kërkesën e tyre në sekretarinë e UBT-së.</p> <p>Informacioni i shqyrtuar dhe diskutuar në vizitën në institucion gjendet në:</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit Aneks 25.2: Ngarkesa mësimore e programit të studimit</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Sikundërse shprehet edhe RVB, por e konfirmuar prej GVJ nga diskutimi me pedagogët e këtij programi studimi, përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e novatore.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi pedagogjik i programit ka konfirmuar mënyrën e diskutimit të syllabuseve dhe programit të çdo lënde për të shmangur përsëritjet e informacionit në lëndë të ndryshme.</p> <p>Programet gjenden të arkivuara dhe në faqen e internetit në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Sikundërse shprehet në RVB dhe paraqitet në Dosjen e plotë të programit, programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi është i strukturuar me një ngarkesë sipas normimit juridik të përcaktuar. Ai përmban 120 kredite të shtrira në dy vite mësimore, me dy semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 kreditesh në çdo vit mësimor (ose 30 kredite për çdo semestër).</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit Aneks 15: Modeli i diplomës</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe njohjen e zbatueshmërisë së tij gjatë vizitës në institucion, sikundërse shprehet edhe në RVB, programi i studimit në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor përmban lëndë të emëtuara dhe kategorizuara për ti krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara në ciklin e tretë.</p> <p>Praktikat mësimore dhe lëndët zgjerojnë mundësinë e përfshirjes së studentëve në punësim në institucione dhe kompani private të ndryshme me fokus të gjerë.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin e depozituar për programin mësimor, shpërndarja e lëndëve gjatë viteve mësimore dhe në secilin prej 4 semestrave synon thellimin e njohurive në fusha specifike. Shpërndarja është e balancuar dhe kalon natyrshëm nga lëndët formuese në ato më specifike që ndihmon studentin të formëzohet si specialist i ardhshëm.</p> <p>Lëndët përmbajnë orët teorike në auditor dhe ato praktike në laborator ose në praktikat mësimore. Në varësi të ngarkesës mësimore në çdo lëndë ndryshon edhe shpërndarja e orëve teorike dhe praktike.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Vlerësimi vjetor, i konfirmuar edhe gjatë vizitës në institucion, ka synuar përmirësimin e vazhdueshëm të raportit dhe shpërndarjes ndërmjet lëndëve apo teorisë dhe praktikës.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e DAME MSc Aneks 14: Dosja e plotë e programit Aneksi 38: Analizë vjetore e departamentit përgjegjës</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në RVB përmendet ndarja rreth 75% të kurrikulës e përbërë prej disiplinave karakterizuese që synojnë në formimin e specialistit të ardhshëm në fushën e menaxhimit mjedisor.</p> <p>Vizita në institucion dhe diskutimi me stafin e DAME dhe zyrën e Karrierës dhe Alumni, konfirmojnë mundësinë dhe lehtësimin në transferimin e studentëve në/nga programe të tjera studimi.</p> <p>Për më tej, studentët janë të punësuar në një gamë të gjerë institucionesh qendrore dhe vendore dhe kompani private. Zyra e Karrierës konfirmon se nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës nuk kanë pasur kërkesa specifike lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program, ndonëse në anën tjetër është theksuar se punësimi i studentëve të porsa diplomuar është kryesisht në pozicione pune jo shumë të kualifikuara.</p>

	<p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p> <p>Aneksi 28: Tabelë me të dhëna përmbledhëse rreth transferimeve të studentëve</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në RVB dhe gjatë vizitës në institucion janë referuar dy periudha të rishikimit më të plotë të kurrikulës, ndërkohë që rishikimi është referuar nga përgjegjësit e njësisë bazë dhe të FBM si proces i vazhdueshëm vjetor. Dy periudhat e referuara në RVB dhe prej stafit përgjegjës ku ndryshimet kanë qenë më substanciale janë 2013-2014 dhe 2017-2018. Ndryshimet kanë konsistuar në futjen e kapitujve të rinj, ri-emërtim dhe ndryshim lëndësh në varësi edhe të tendencave më të fundit në fushën e menaxhimit mjedisor.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Shqyrtimi i dosjes së plotë të studimeve (Aneks 14) konfirmon se tërësia e programit mësimor, kurrikulës dhe syllabuseve specifike të çdo lënde mundësojnë që në fund të studimeve dhe pas përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara për studentin, ai të ketë mundur të përmbushë objektivat studimore dhe kërkimore shkencore të këtij programi studimi.</p> <p>Në fund të studimeve, studenti i diplomuar përmbush kriteret e vlerësimit si specialist në fushën e menaxhimit të mjedisit dhe të bujqësisë, me aftësi dhe kompetencë profesionale për të adresuar çështje praktike dhe të detyrave institucionale në vendin e punës.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneks 19: Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe njohjen e zbatueshmërisë së tij gjatë vizitës në institucion, sikundërse shprehet edhe në RVB, programi i studimit në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisit përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara për të krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara në ciklin e tretë.</p> <p>Për më tej, studentët janë të punësuar në një gamë të gjerë institucionesh qendrore dhe vendore dhe kompani private. Zyra e Karrierës konfirmon se nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës nuk ka pasur kërkesa specifike lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program, ndonëse në anën tjetër është theksuar se punësimi i studentëve të porsa diplomuar është kryesisht në pozicione pune jo shumë të kualifikuar.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për më tej, studentët janë të punësuar në një gamë të gjerë institucionesh qendrore dhe vendore dhe kompani private. Zyra e Karrierës konfirmon se nga kompanitë private që kanë marrë pjesë në Panairin e punës nuk ka pasur kërkesa specifike lidhur me formimin specifik të studentëve në këtë program, ndonëse në anën tjetër është theksuar se punësimi i studentëve të porsa diplomuar është kryesisht në pozicione pune jo shumë të kualifikuar.</p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Rreth 30 Doktoratura janë përfunduar dhe mbrojtur pranë Departamentit DAME, kryesisht me studentë të ciklit të dytë apo edhe të transferuar nga programe të tjera studimi.</p> <p>Lëndët dhe infrastruktura e DAME mundësojnë vijimin e studimeve dhe të kërkimit shkencor në ciklin e tretë.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit</p> <p>Aneks 16: Vlerësim i tregut të punës</p> <p>Aneks 19: Syllabuset e lëndëve</p> <p>Aneks 26: Të dhëna për programet e ofruara nga DAME</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Në përbërje të stafit të DAME janë 44 personel akademik nga të cilët 22 personel akademik efektiv (PAE), 12 personel akademik me kontratë (PAK) dhe 10 punonjës mbështetës dhe administrativ (PA). I gjithë stafi është i përfshirë me kohë të plotë pune.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Në këtë program studimi janë të përfshirë 16 personel akademik i DAME, nga të cilët 12 mbajnë titullin Prof., 1 ka titullin Prof. As., dhe 3 janë Doktor. Titullarët e lëndëve janë të kategorisë Profesor, me përjashtim të një lënde: Ekonomia e Burimeve Natyrore & Legjislacion Mjedisor (titullari është Doktor). Në këtë program studimi nuk referohet asnjë personel i ftuar, i jashtëm. Stafi akademik është i angazhuar edhe në programe të tjera studimi (Bachelor, Master Profesional) të ofruara nga institucioni dhe vlerësohet i mbingarkuar me deri në 401 orë në vit. Të gjithë (përveç një punonjësi), janë të përfshirë me ngarkesë më të madhe se norma. Personeli me tituj ka deri në 400 orë (nga 140 të përcaktuar si normë). Mbingarkesa është referuar në takimet me stafin si një problem i adresuar. Zvogëlimi i numrit të studentëve në cikle të ndryshme dhe përfshirja e doktorantëve të nivelit të tretë të studimit do të ndihmojë në zvogëlimin e mbingarkesës së pedagogëve të tjerë në programin mësimor. Shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik jep informacion se i tërë stafi akademik ka kryer ose është në proces kualifikimi për marrjen e titujve dhe gradave si dhe ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime të gjata dhe shkurtra jashtë vendit. Personeli përbëhet nga staf me kohë të plotë. GVJ konfirmon se gjatë vizitës në institucion në Zyrën e Burimeve Njerëzore ka një procedurë të qartë dhe përcaktuar të punësimit të stafit të ri sipas kërkesave të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në nivelin e Departamentit. Stafi i punësuar në tre vitet e fundit kanë përfunduar studime pranë këtij Departamentit dhe në universitete jashtë vendit. Personeli akademik ka në dosjen e personelit dokumentacionin e plotë të kualifikimeve të marra ndër vite. Aneks 11: Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Aneks 23: Të dhëna për stafin akademik në programin mësimor

<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ konfirmon se grupet kërkimore në kuadër të DAME, të cilat janë edhe kontribuesit kryesorë në zbatimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Agromjedisi kanë profilizimin shkencor në fushat ku mbulojnë kërkimin shkencor dhe janë titullarë të lëndëve të programit mësimor.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit Aneks 11: Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Aneks 20: CV te personelit akademik Aneks 24.2: Të dhëna për stafin akademik në programin mësimor</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon informacionin e dhënë në RVB dhe dokumentacionin e depozituar mbi marrëveshjet e lidhura me institucione të ndryshme të nivelit qendror dhe vendor dhe kompani private, me qëllim kryerjen e praktikës profesionale në semestrin katërt të studimeve (30 kredite) për një periudhë 4-5 javore. Ato kryhen në institucione apo kompani private mbi bazën e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit.</p> <p>Përgjegjësi i DAME përcakton pedagogët përgjegjës për ndjekjen e studentëve në zbatimin e praktikës profesionale.</p> <p>Pedagogu përgjegjës ndjek zbatimin e praktikës profesionale. Futja në bashkëveprim me një institucion/kompani formalizohet mbi bazën e marrëveshjeve standarde. Progresi i punës së studentit monitorohet nga institucioni pritës dhe fakulteti. Në fund studenti paraqet një relacion dhe prezanton detyrat e kryera/të përbushura.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Gjate vizitës në institucion, GVJ ka konfirmuar me përgjegjësën e njësisë bazë numrin e personelit mbështetës dhe administrativ (ndihmës mësimor dhe shkencor), i cili përbëhet nga 10 vetë (31% e gjithë personelit të DAME), kryesisht përgjegjës për labororet në strukturën e njësisë bazë. Personeli ndihmës ndihmon në procesin mësimor kryesisht orët laboratorike dhe procesin e kërkimit shkencor për realizimin e temave kërkimore të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			✓	

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Mundësia e njohjes me kërkesat e tregut të punës realizohet përmes Marrëveshjeve të Bashkëpunimit apo të pjesëmarrjes së kompanive të ndryshme në panairin e punës të organizuar rregullisht çdo vit në UBT. Për këtë program studimi interes të veçantë kanë kompani të cilat merren me monitorim dhe menaxhim mjedisor. Ndonëse nuk ka një fokus shumë të përcaktuar të kompanive më të interesuara për studentë të diplomuar në</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>këtë program studimi, kompanitë më të interesuara janë ato të fermave, fabrikave të përpunimit, etj. Në takimin me stafin akademik është shprehur drejtpërsëdrejti interesi dhe përpjekja për të përmirësuar programin e studimit në lëndë të veçanta në mënyrë që të kryhet një përputhje sa më e mirë me tregun e punës.</p> <p>Aneks 17: Analizë e tregut të punës DAME 2019 Aneks 29: Të dhëna të punësimit të studentëve</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni kryen gjurmimin e studentëve të diplomuar përmes anketimit të kryer. Bazuar në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, shkalla e informacionit të grumbulluar është e ulët (deri në 10% ose edhe më pak). Zyra e Karrierës dhe Alumni shprehet se duhen kërkuar rrugë dhe mënyra të tjera që mund të sigurojnë informacion më të plotë për studentët e diplomuar në këtë program studimi për një periudhë disa vjeçare. Mënyra e kontaktit përmes emailit, për të plotësuar pyetësorin specifik për gjurmimin duhet parë vetëm si një ndër mënyrat e grumbullimit të këtij informacioni. GVJ konfirmon se një pjesë e informacionit vijon të merret përmes kontakteve personale të stafit të programit me studentët e punësuar, të cilët vijojnë komunikimin me stafin pedagogjik të njësisë bazë për të marrë informacione të ndryshme apo tërhequr dokumentacionin lidhur me studimet e kryera.</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>DAME ka ndërmarrë një sërë nismash për të zhvilluar dhe akredituar ose certifikuar programe të veçanta dhe të posaçme si përshebull Vlerësuesi i Ndikimit në Mjedis (VNM), cili njihet prej Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe ka qenë institucion referencë për këtë certifikim. Kurse të tjera të referuara në RVB janë Kursi i Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme, etj. Kjo nismë mundëson që vetë studentët e diplomuar në këtë program studimit të mund të vijojnë certifikimin e tyre për VNM si pjesë e avancimit të tyre profesional në institucionet apo kompanitë private.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

<p>Standardi II.7 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ konfirmon përmes shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar se programi i studimit Master Shkencor Inxhinieri Agromjedisit, ka të përcaktuar qartë objektivat mësimore dhe kërkimore shkencore të tij të shprehura në dokumentacionin bazë të institucionit si në statutin e UBT-së ku shprehet se qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi është në koherencë me atë të institucionit në tërësi “ ... për përgatitjen e specialistëve të fushës së bujqësisë dhe mjedisit ...”.</p>

	<p>Fusha e veprimtarise së institucionit në tërësi dhe të njësisë bazë që zbaton këtë program janë gjetur në përputhje të plotë. Programi konfirmohet të formojë dhe kualifikojë specialistë të fushës së <i>mjedisit dhe të bujqësisë në drejtimet e menaxhimit mjedisor, të burimeve natyrore dhe bujqësisë</i>”.</p> <p>Aneks 2: Statuti i UBT-së</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Duke ju referuar Planit Strategjik 2016-2025 dhe detyrës institucionale të njësisë bazë, GVJ konfirmon së DAME si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi është e përfshirë në një sërë fushash kërkimi shkencor të cilat janë rezultat i zhvillimit historik dhe ndjekjes së dinamikave të tregut në vitet e fundit.</p> <p>Fushat kryesore të studimeve janë të grupuara në tre grupet kërkimore shkencore dhe mbulojnë drejtime të tilla si menaxhimi i tokës, ndotja e tokave, burimet natyrore dhe biodiversiteti, habitatet dhe ekosistemet bujqësore.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin akademik dhe grupet kërkimore është konfirmuar zbatimimi i lirisë akademike në përzgjedhjen e fushave specifike të kërkimit shkencor, në zbatim të objektivave strategjike të DAME.</p> <p>Aneks 43.5: Plani strategjik i UBTsë</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vlerëson se përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor realizohet në kuadër të realizimit të punës së diplomës në periudhën e fundit të studimeve në këtë cikël studimi. Studentët përfshihen kryesisht në fushat e kërkimit shkencor të drejtuara nga titullarët e lëndëve dhe stafi tjetër akademik me tituj.</p> <p>Çdo pedagog drejton 1-2 studentë në çdo vit mësimor. Gjatë vitit 2018-2019 janë 30 studentë të cilët kanë në proces tema të tilla kërkimi shkencor. GVJ konfirmon se në takimin me stafin akademik kjo detyrë nuk ka paraqitur problematika të ngarkesës mësimore dhe është referuar si e menaxhueshme.</p> <p>DAME është e përfshirë në disa studime me rëndësi kombëtare kryesisht në monitorimin e ndikimit mjedisor si psh. gazsjellësi TAP, etj. Kjo vlerësohet mundësi e mirë e përfshirjes së studentëve në punë kërkimore konkrete për të zhvilluar me tej aftësitë praktike në laborator apo të vëzhgimit në terren.</p> <p>Aneks 43.1: Të dhëna për kërkimin në DAME.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se DAME realizon të ardhura shërbime për të tretë në kuadër të analizave që kryen në Laboratorin Shkencor të akredituar. Lista e çmimeve për të tretë është afishuar dhe aplikohet për një sërë analizash. Gjatë vitit 2018, është shtuar numri i analizave duke synuar edhe mbulimin e analizave të lidhura me ujin.</p> <p>Gjithashtu, të ardhura krijohen edhe prej Kurseve të Vlerësimit të Pasurive të Paluajshme, etj.</p> <p>Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik u ngrit problemi i mungesës së një fondi të dedikuar për kërkimin shkencor të nivelin e njësisë bazë. Fonde minimale që mund të lidhen me raste specifike akordohen në nivel Universiteti (UBT), ndërkohë të ardhurat e krijuara në nivelin e DAME</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se DAME realizon të ardhura shërbime për të tretë në kuadër të analizave që kryen në Laboratorin Shkencor të akredituar. Lista e çmimeve për të tretë është afishuar dhe aplikohet për një sërë analizash. Gjatë vitit 2018, është shtuar numri i analizave duke synuar edhe mbulimin e analizave të lidhura me ujin.</p> <p>Gjithashtu, të ardhura krijohen edhe prej Kurseve të Vlerësimit të Pasurive të Paluajshme, etj.</p> <p>Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik u ngrit problemi i mungesës së një fondi të dedikuar për kërkimin shkencor të nivelin e njësisë bazë. Fonde minimale që mund të lidhen me raste specifike akordohen në nivel Universiteti (UBT), ndërkohë të ardhurat e krijuara në nivelin e DAME</p>

	apo fonde të dedikuara për kërkimin shkencor vlerësohen të mangëta dhe të pamjaftueshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi II.8				
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konfirmon përmes diskutimit me përgjegjësit e FBM dhe të DAME, informacionin e dhënë në dokumentacionin e paraqitur për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të lidhura me institucione të ndryshme. Ky bashkëpunim ndihmon në arritjen e objektivave të programit të studimit lidhur me kërkimin shkencor në fushat tradicionale dhe të reja të kërkimit në këtë departament. Aneks 34: Listë e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me institucione të ndryshme Aneks 43: Të dhëna mbi kualifikimin e stafit akademik në 5 vitet e fundit			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DAME është përfshirë në kryerjen e analizave dhe të vlerësimeve për të tretët. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe atë të Laboratorit Shkencor u referuan disa studime me rëndësi kombëtare kryesisht në monitorimin e ndikimit mjedisor si psh. gazsjellësi TAP, etj. Kjo vlerësohet mundësi e mirë e përfshirjes së studentëve në punë kërkimore konkrete për të zhvilluar më tej aftësitë praktike në laborator apo të vëzhgimit në terren.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ konfirmon se informacioni i dhënë në RVB mbi konferencat shkencore të organizuar prej DAME apo ku kjo njësi bazë ka qenë kontribuese me referime dhe kumtesa shkencore. Gjatë 5 vjetëve të fundit janë organizuar 5 konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare (<i>Shënim: Ne RVB referohen 4 konferenca, meqë Konferenca më e fundit është organizuar në prill 2019</i>). Fushat kryesore të këtyre ngjarjeve shkencore me karakter ndërkombëtar kanë qenë studimi i Tokës (maj 2015), Ekologjisë bujqësore (qershor 2017); Bujqësisë dhe menaxhimit mjedisor (Prill 2017, Maj 2018, Prill 2019) Dokumentacioni dhe informacion mbi punimet dhe programin e tyre gjendet në internet në faqen e institucionit www.ubt.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, rezulton se institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për nxitjen e përdorimit të metodave novatore në mësimdhënie përfshirë lëndët dhe modulet gjatë gjithë ciklit akademik. Prej 2010 është hartuar Udhëzuesi për krijimin e faqeve personale për të menaxhuar informacionin didaktik për studentët nëpërmjet Google Site. Prej 2016, në nivel të UBT-së përcillet një plan masash për zbatim në të gjitha njësitë.</p> <p>Aneks 4: Plani i masave për mirëfillimin dhe mirë vijimin e vitit akademik Aneks 46: Udhëzues në internet: Manual regjistrimi</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së DAME dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UBT (prej Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional) vlerësohet në mënyrë të rregullt, vjetore, niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të DAME për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Aneks 5: Rregullore e studimeve universitare Aneks 6: Rregullore e brendshme e FBM Aneks 13: Manual i cilësisë në UBT 2018</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konfirmon se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional vlerëson në mënyrë të rregullt, në periudha vjetore, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetësori.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program.</p> <p>Pyetësori plotësohet në përfundim të programit të leksioneve, përpara testimit të njohurive. Ai menaxhohet nga personeli jashtë DAME, është anonim dhe plotësohet në format të shtypur. Ndonëse është referuar edhe një pyetësor on-line, ka pasur paqartësi lidhur me një pyetësor on-line prej studentëve, të cilët kanë referuar se parapëlqejnë versionin e shtypur.</p> <p>Takimi me studentët në institucion konfirmoi rëndësinë e një vlerësimi të tillë, meqënëse studentët janë shprehur se ndjehen të lirshëm në vlerësimin e tyre dhe SZKV ka konfirmuar grumbullimin e informacionit të vlefshëm prej studentëve lidhur me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në tërësi.</p>

	<p>Aneks 5: Rregullore e studimeve universitare Aneks 6: Rregullore e brendshme e FBM Aneks 13: Manual i cilësisë në UBT 2018 Aneks 40: Pyetësor i studentëve</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka konfirmuar gjatë vizitës në institucion se institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. Raporti i hartuar në nivel departamenti (DAME), shpërndahen dhe diskutohen në njësinë bazë për përmirësimin e punës në të vitin e ardhshëm akademik. Në RVB referohet se nga viti i ardhshëm akademik 2019-2020, rezultatet e këtij vlerësimi do të vendosen edhe on-line.</p> <p>Nxitja e stafit akademik për zbatimin e praktikave të mira referohet të jetë kryer përmes bërjes publike të rezultateve të anketimit të studentëve dhe përmes rrugëve të tjera si organizimi i leksioneve të hapura për stafin akademik dhe studentët në programin e studimit.</p> <p>Aneks 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konfirmon se DAME dhe personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies: leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale. Gjatë takimit me stafin akademik dhe koordinatoren e programit të studimit u paraqit se vemëndje e veçantë i kushtohet pjesës praktike (kryesisht punës në laborator) për të rritur aftësitë praktike të studentëve. Grupe prej tre studentësh përfshiheshin në punën në Laboratorin shkencor si ndihmues në kryerjen e analizave të caktuara. Hartimi i një plan-shpërndarje të studentëve garanton që të gjithë studentët të kenë një mundësi të tillë.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programit</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,</p>	<p>Stafi akademik ka konfirmuar në takimet gjatë vizitës në institucion se përpiqet të adresojë nevojat e veçanta të studentëve, përfshirë edhe interesat e tyre specifike për avancim në fusha të caktuara të kërkimit.</p>

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në takimin me drejtuesit e grupeve kërkimore u theksua se studentëve u lihej e hapur alternativa e zgjedhjes së temave të diplomave në fushat ku ata dëshironin të vijonin zhvillimin profesional. Në rrugë tjetër e paraqitur në takimet me stafin, referuar edhe në RVB, është organizimi i punës në grupe të vogla studentësh për detyra kursi apo prezantime të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues për personelin akademik që të zhvillojë aftësitë e veta lidhur me përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit përmes udhëzuesve të hartuar (2010).</p> <p>Mundësia e përdorur më shpesh është përfshirja në Marrëveshjet e Bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë vendit, ku një numër i madh anëtarësh të personelit akademik kanë përfituar mobilitete dhe kanë marrë pjesë në aktivitete shkëmbimi. Në 44 marrëveshjet e bashkëpunimit, stafi i DAME ka përfituar në të gjitha ato programe ku fusha e veprimtarisë përputhet me aktivitetet e parashikuara në këto Marrëveshje.</p> <p>Zyrat e Sekretarisë dhe ajo e Karrierës dhe Alumni informojnë mundësitë e shkëmbimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale të pedagogëve në internet.</p> <p>Aneks 4: Plani i masave të UBTsë Aneks 38: Raporti analizës vjetore të DAME</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet e marra prej stafit akademik dhe në rezultatet e grumbulluara prej pyetësoreve me studentët, GVJ vlerëson se stafi akademik është në nivelin e duhur të kompetencës për tu përfshirë në procesin e mësimdhënies.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Titullarët e lëndëve janë me titull të kategorisë Profesor (12 nga 16 personel akademik i përfshirë); Në një rast ky kriter nuk përmbushet (një lëndë e ka titullarin Doktor); - CV-të e stafit përbajnë kualifikime të mjaftueshme për përfshirjen në mësimdhënie; - Stafi mbetet i angazhuar në procesin e kërkimit shkencor me rreth 54 artikuj shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit, 14 prej të cilëve me faktor impakti. <p>Procesi i rekrutimit të stafit të ri, përmes kriterëve specifike të rekrutimit, garanton cilësinë në mësimdhënie.</p> <p>Gjatë takimit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Pagave, u sugjerua përfshirja në procesin e vlerësimit edhe e aftësive prezantuese dhe argumentuese të aplikantëve kandidatë për staf akademik, të cilët planifikohen të jenë pjesë e stafit mësimdhënës në këtë program studimi.</p> <p>Aneks 6: Rregullore e brendshme e FBM Aneks 11: Rregullore e ZBNjP Aneks 19: Syllabuset e lëndëve të programit</p>

	Aneks 20: CV të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Aneks 24.2: Të dhëna Tabelë për Stafin Akademik MSc			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sikundërse u theksua për Kriterin 1 të këtij standardi, DAME përdor një larmishmëri formash dhe metodash standarde dhe të reja në mësimdhënie. Futja e teknikave të reja të prezantimit përmes përdorimit të video projektorëve, apo të formave interaktive të diskutimit në seminare, punë/detyra kursi dhe prezantime të formave të tjera mundëson përfshirjen e studentëve.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju prezantua matja e rezultateve dhe performacës edhe përmes pjesëmarrjes së studentëve në orët e leksioneve dhe të seminareve. Sikundërse u referua pjesëmarrja e lartë është tregues interesi prej studentëve. Nga ana tjetër, takimi me grupin e studentëve konfirmoi përdorimin e teknikave të ndryshme që e bëjnë orën mësimore jo vetëm më tërheqëse por edhe më efektive në përthithjen e njohurive dhe nxitjen e mendimit kritik.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Megjithatë, stafi akademik në takimin me GVJ theksoi se ky është një proces i vazhdueshëm përmirësimi dhe ndryshimi, që kërkon angazhim institucional dhe individual të përhershëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	DAME ka infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie në disa godina të UBT-së, të shpërndara në një reze të vogël dhe të aksesueshme lehtësisht. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ vëzhgoi mjediset në funksion të zhvillimit të programit të mësimit, salla leksionesh dhe mjedise laboratorike të përdorura në këtë program studimi. Mjediset janë rikonstruktuar vitet e fundit dhe janë në gjendje të mirë. Auditorët mësimorë të vizituar kanë kapacitete të mjaftueshme deri në 50-60 studentë. Ata janë të pajisur me sistem ventilimi/kondicionimi, me pajisje individuale, video-projektorë me mundësi për tu lidhur me laptopë/kompjuter, tabela shkrimi me lapëstila. Hapësira dhe ndriçimi garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të mira të mësimdhënies. RVB konfirmon se hapësira në dispozicion përmbush standardin e përcaktuar në VKM 418 (2017) për 2.5 m ² /student. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me bazë materiale. Pajisjet janë për përdorim në grupe studentësh. GVJ vërejt se laboratorët kanë nevojë për përmirësimin dhe rifreskimin e pajisjeve dhe mjeteve të laboratorit në mënyrë që të rritet gama e punëve praktike të kryera në to.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	
	Aneks 42: Të dhëna për infrastrukturën në programin e studimit

<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ konfirmoi dhe vizitoi dy salla kompjuterësh të lidhur me internet në nivel universiteti, të cilat janë dispozicion të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Takimi me stafin dhe studentët konfirmoi nxitjen e përdorimit të programeve kompjuterike bazë, por nuk ka programe specifike profesionale të referuara.</p> <p>Në punën shkencore apo atë për diplomat përdorimi i GIS, ose të përpunimit statistikor SPSS, bëhet nga disa prej studentëve por nuk ka ndonjë organizim insitucional për mbështetjen e studentëve në përdorimin e programeve të tilla specifike.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Shqyrtimi i DVV (syllabusit e lëndëve) si dhe takimi me stafin e programit të studimit, mundëson GVJ të konfirmojë se çdo lëndë ka literaturën e sugjeruar bazë dhe ndihmëse. Ajo ofrohet në formën e librave të shtypur, të cilët vihen në dispozicion të studentëve në mjedise të caktuara të UBT-së. Gjithashtu literatura ndihmëse apo ajo në shërbim të elementëve pjesorë (tema seminaresh, detyrash kursi, etj) ofrohet si informacion digjital (version pdf ose faqe interneti) ose përmes bibliotekës së UBT-së.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në UBT, GVJ vëzhgoi edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Pas dëmitmit në 1997, Biblioteka ka një fond prej 30000 librash dhe revista në gjuhën shqipe dhe të huaja për fusha të ndryshme studimi si dhe 5000 volume periodiku (shqip dhe të huaj). Në të u prezantua edhe një fond i ri në drejtimet e programit të studimit për nevojat e studentëve dhe stafit akademik për kërkimin shkencor dhe mësimin. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka ka sallën me 12 kompjuterë të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Salla e kompjuterëve shfrytëzohet nga studentët edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit.</p> <p>Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime në revista shkencore.</p> <p>Mundësimi prej RASH i bibliotekës on line do të ndihmojë studentët më tej në përmbushjen e nevojave të tyre dhe stafin pedagogjik për të zgjeruar gamën e burimeve të literaturës on line.</p> <p>Gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik u theksua se përdorimi i burimeve të bibliotekës rritej kur studentëve u jepeshin detyra konkrete.</p> <p>Aneks 3.1: Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-së, 2016-2025. Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit Aneks 45: Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave</p>	<p>Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë DAME disponon dy laboratorë mësimorë, të cilët u vizituan gjatë ditëve të vizitës në</p>

<p>të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>institucion. Përdorimi i tyre i ishte dedikuar orëve laboratorike për të gjithë ciklet e studimit me kapacitete deri në 15-20 studentë, ku puna kryesisht organizohet e grupuar.</p> <p>Në shtesë, funksionon Laboratori Shkencor i Mjedisit, i cili është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analiza në fushën e tokës, mbetjeve dhe ujërave. Laboratori është në dispozicion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Laboratori siguron kushtet mjedisore të përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për aktivitetin laboratorik të testimit. Laboratori është në pajtueshmëri të plotë me Standardet S SH ISO/IEC17025:2006</p> <p>Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</p> <p>Aneks 14_20: Çertifikata e Akreditimit LAME_2014_2018.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB, Institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtijshëm të stafit. Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E-learning - që përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin, e cila zhvillohet me ndihmën e pajisjeve elektronike. Me këto metoda, materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime power-point, audio, video, teste, forume, animacione, etj. • Moduli online “Njohuria mbi informacion” - Studenti mëson se si të gjejë informacionin e duhur që u shërben për të shkruar një detyrë/punë shkencore, duke shfrytëzuar tre llojet e burimeve të informacionit; si ta vlerësojnë atë, duke përdorur filtrat e nevojshëm; dhe si ta përdorin informacionin në mënyrë efektive në dobi të tyre, duke adresuar siç duhet nevojat e detyrës/punës shkencore. • TEEAL - Biblioteka Themelore Elektronike Bujqësore, është një bazë të dhënash me tekste të plotë të artikujve nga më shumë se 450 revista kërkimore, me cilësi të lartë në fushën e bujqësisë dhe në shkencat e lidhura me të. <p>Për sa më sipër, GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafet akademike dhe studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u prezantua me disa metoda komunikimi të stafit akademik dhe studentëve:</p> <p>Google site - Me anë të këtij aplikacioni mund të mblidhen lehtë dhe shpejt një sërë informacionesh në një site të vetëm. Studentët nëpërmjet google site kanë mundësinë të aksesojnë materialet e leksioneve dhe informacionet e digjitalizuara, të ngarkuara nga pedagogu.</p> <p>Sistemi ESSE3, sistem i menaxhuar nga RASH, është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Qëllimi kryesor është vënia në punë e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit</p>

<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Rregulloret e funksionimit të FBM dhe DAME shprehin se pedagogët e kanë detyrë funksionale të orientojnë studentët në zgjedhjen e temave të tyre të diplomës dhe të drejtojnë ata për realizimin e saj.</p> <p>Pas përbushjes së detyrimeve, studenti mund të shprehë interesin e tij për fushën në të cilën dëshiron të punojë. DAME përpiqet të përputhë interesat e studentëve me drejtimet e punës kërkimore të saj.</p> <p>Takimi me stafin akademik të programit konfirmoi për GVJ se studentët janë të përfshirë kryesisht në tema të karakterit praktik (vlerësimi mjedisore). Por disa tema janë edhe të karakterit kompilues.</p> <p>Aneks 5: Rregullore e studimeve UBT Aneks 6: Rregullore e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore e programit të studimit</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konfirmon se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, në nivelin e UBT-së vlerëson në mënyrë të rregullt, në periudha vjetore, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetëso. Çdo fillim viti akademik, SZKV përgatit një komunikim për të gjitha njësitë, duke udhëzuar lidhur me strukturën dhe organizmin e procesit mësimor në atë vit akademik.</p> <p>Struktura e vlerësimit të cilësisë është e ndërtuar edhe në nivel Fakulteti, pranë FBM.</p> <p>Aneks 5: Rregullore e studimeve universitare Aneks 6: Rregullore e brendshme e FBM Aneks 13: Manual i cilësisë në UBT 2018</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së DAME dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UBT (prej Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional) vlerësohet në mënyrë të rregullt, vjetore, niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur prej këtij sektori dhe mbi shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të DAME për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Aneks 5: Rregullore e studimeve universitare Aneks 6: Rregullore e brendshme e FBM</p>

	Aneks 13: Manual i cilësisë në UBT 2018			
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ pohon se gjatë takimeve me stafin akademik, sikundërse referohet edhe në RVB, janë cituar një numër leksionesh të hapura nga pedagogë të njësisë bazë apo edhe të ftuar. Ndonëse nuk ka një listë të shprehur qartë me data, vendin dhe lektorin, kjo praktikë është referuar në disa raste.			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sikundërse është pohuar prej GVJ, kualifikimi i stafit akademik është kryer kryesisht përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe aktivitete shkëmbimi me institucione homologe jashtë vendit. Tregues të ecurisë shërbejnë botimet shkencore dhe lista e programeve të shkëmbimit ku stafi i DAME ka marrë pjesë.			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Aneks 20: CV të stafit akademik Aneks 43: Të dhëna mbi kërkimin shkencor në DAME			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Rregulloret e Njësisë bazë dhe të programit të studimit shprehin qartë përgjegjësinë ligjore dhe funksionale të stafit të DAME për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ato përcaktojnë si detyrë funksionale të personelit të DAME arritjen e objektivave më të larta në cilësinë e punës mësimore dhe shkencore. GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të kryer çdo vit nga DAME për ecurinë e zbatimit të programit të studimit, kryhet vlerësimi i metodave të reja, nëse ka pasur, dhe stimulohet futja dhe përdorimi i tyre kur vlerësohen të efektshme. Kështu, në takimin me stafin akademik është vlerësuar i efektshëm përfshirja e studentëve në detyra kursi dhe planifikimi me grupe të vogla i punës në laboratorin shkencor, të cilat ndihmojnë në krijimin e aftësive të reja praktike tek studentët.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Ndonëse GVJ është informuar për një praktikë të tillë, përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e mësimdhënies apo të kërkimit shkencor është e kufizuar. Ato janë organizuar në formatin e vizitave studimore, konferencave e takimeve të organizuara në nivel fakulteti apo universiteti, pjesëmarrje në vlerësimin e diplomave, etj. Dokumentacioni i vetëvlerësimit nuk ka të dhëna sasiore për këtë fushë.			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Ndonëse GVJ është informuar për një praktikë të tillë, përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e mësimdhënies apo të kërkimit shkencor është e kufizuar. Ato janë organizuar në formatin e vizitave studimore, konferencave e takimeve të organizuara në nivel fakulteti apo universiteti, pjesëmarrje në vlerësimin e diplomave, etj. Dokumentacioni i vetëvlerësimit nuk ka të dhëna sasiore për këtë fushë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të	Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik (detyrat e kursit, punët laboratorike, detyrime të tjera,

<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>provimet), njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme, procedurat e vlerësimit të dijeve, apo punimet e diplomës. Sistemi garanton njoftimin e studentëve nëpërmjet e-mailit. Gjithashtu, pedagogët në faqet e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkte japin informacion të hollësishëm për studentët për lëndët e tyre. ZKS ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e informacionit të nevojshëm në mënyrën më të përshtatshme.</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, praktika e njoftimit të detyrimeve të studentit, metodologjia e vlerësimit dhe përshkrimi i syllabusit të lëndës është detyrim ndaj çdo pedagogu/titullari dhe përmbushet në fillim të procesit mësimor për atë lëndë.</p> <p>Gjithashtu, studentët vlerësojnë se ndjehen mjaftueshëm të informuar përmes pedagogëve për detyrimet e tyre dhe mënyrën e operimit për çdo lëndë specifike.</p> <p>Aneks 7: Rregullore e programit të studimit Aneks 19: Syllabuset e lëndëve</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB dhe konfirmuar prej GVJ gjatë vizitës në institucion, vlerësimi i dijeve realizohet në formate të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i vazhduar përmes kontrolleve të njohurive të marra gjatë procesit mësimor, në periudha të ndërmjetme (referohet java e tetë e semestrit); 2. Detyrat e kursit, të cilat janë individuale dhe përmbushen gjatë vitit mësimor; 3. Testimi përfundimtar. <p>Mënyra e vlerësimit në testin final është me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar.</p> <p>Kjo mënyrë vlerësimi është e shprehur në rregulloret e funksionit të institucionit dhe të programit të studimit dhe ju bëhet e ditur studentëve në fillim të programit mësimor të ciklit të dytë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Sipas DVV dhe verifikimit gjatë vizitës në institucion, DAME si njësi përgjegjëse organizon dhe menaxhon procesin e testimit dhe të vlerësimit të njohurive për programin e studimit.</p> <p>Vlerësimi bëhet me notë sipas sistemit me 10 nota. Vlerësimi ndahet në dy pjesë sikundërse paraqitet edhe në syllabusin e lëndës: Vlerësimi i vazhduar i kryer gjatë procesit mësimor zë nga 30%-40% të vlerësimit përfundimtar. Takimi me stafin akademik konfirmon se kjo është një mënyrë për të nxitur mësimin e vazhduar prej studentëve dhe arritjen e</p>

	<p>rezultateve më të mira në përfundim, ndaj tendenca është kalimi drejt 50% në disa lëndë të veçanta.</p> <p>E drejta për tu futur në provim vlerësohet nga pedagogu i lëndës pas përmbushjes së detyrimeve të lëndës gjatë procesit mësimor.</p> <p>Testimi i kryer në provimin përfundimtar të lëndës kryhet më shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar.</p> <p>Aneks 5: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullorja e studimeve në DAME MSc</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB, institucioni nuk ka sisteme të vlerësimit elektronik. Forma e përdorur është ajo standarde me shkrim. Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen në sistemin ESSE3.</p>
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Komisioni i provimit ngrihet prej përgjegjesit të DAME, me të paktën dy anëtarë të stafit akademik, ku njëri është titullari i lëndës. Të dy anëtarët marrin pjesë në provim dhe vlerësimin e studentit.</p> <p>Në takimet me stafin dhe studentët nuk janë referuar problematika lidhur me këtë mënyrë vlerësimi/kontrolli të dijeve.</p> <p>Procedura e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve të provimit është e përshkruar në rregulloret e institucionit.</p> <p>Aneks 5: Rregullorja e studimeve në UBT Aneks 6: Rregullorja e FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullorja e studimeve në DAME MSc</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	<p>GVJ konfirmon shprehjen në RVB se testimi me anë të provimit bëhet i sekretuar. Procesi i sekretimit kryhet nga personeli ndihmës mësimor.</p> <p>Procesi i sekretimit ende nuk kryhet me infrastrukturë të posaçme/veçantë.</p> <p>RVB thekson se UBT është në procesin e futjes së një sistemi të sofistikuar sekretimi me kod bar, i cili pritet të vihet në funksionim vitin e ardhshëm. Me këtë sistem të ri pritet të rritet më tej transparenca dhe paanshmëria në vlerësimin e njohurive të studentëve në testet përfundimtare.</p>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>GVJ konfirmon se gjatë procesit të vlerësimit të elementëve të një moduli si testi i ndërmjetëm, detyrat e kursit dhe provimi final i lëndës, stafi akademik bën komente të korigjimit në rastin e provimeve ose komente të drejtpërdrejta në provimet me gojë në detyrat e kursit që ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin në këtë proces.</p> <p>Për këtë qëllim studentët kanë periudhën e ankimit pasi janë njohur me vlerësimin në sistemin ESSE 3.</p>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>DAME konfirmon seriozitetin në kryerjen e testimit përmes mos lejimit të personave të jashtëm të futen në provim, respektimin e orarit dhe masave parandaluese për kopjim.</p>

	Lidhur me plagjaturën, GVJ ka konstatuar se ajo synohet të parandalohet përmes komunikimit pedagog student, por ende nuk ka një mjet (software) vlerësues në përdorim të njësisë bazë për këtë qëllim.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi me anë të testimit siguron përfshirjen e opinionit të studentëve në procesin e vlerësimit dhe të kontrollit. Komentet e studentëve reflektohen në analizën vjetore. Njëpërmjet këtyre anketimeve studentët shprehen edhe mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve. Aneks 40.6: Pyetësor i Studentëve. Aneks 40.7: Analiza e Rezultateve të Anketimit.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar në takimin me stafin dhe studentët se njohja me procesin e vlerësimit kryhet si detyrim i prezantimit të lëndës në fillim të çdo semestri. Për më tej, studenti merr informacion rreth vlerësimit të përgjigjes së tij përmes platformës ESSE3, ku vihet në pikët e grumbullura gjatë vitit dhe atyre në provim. Në rast të gjykimit për vlerësim jo të saktë, studenti ka dy ditë kohë për të shprehur mendimin e tij dhe të shohë dokumentacionin e vlerësimit. Pedagogu paraqet qëndrimin e tij, i cili mund të mos ndryshojë ose të kryejë rivlerësim nëse gjykohet i arsyeshëm. Ky proces më pas reflektohet në notën vlerësuese për lëndën. Gjatë takimeve në institucion nuk u paraqit ndonjë problematikë lidhur me zbatimin e këtij kriteri. Aneks 7: Rregullore e programit të studimit Aneks 14: Link i modulit në shqip: http://ubt.edu.al/sites/default/files/albagt_final/albagt_start.html .			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	GVJ është informuar gjatë vizitës në institucion se në rast ankimi, studentët ndjekin procedurën e ankimimit me shkrim drejtuar Përgjegjësit të DAME dhe Dekanit të FBM. Ankesa merret në shqyrtim prej titullarit, dhe në varësi të rastit mund ti referohet Titullarit të lëndës ose ngrihet një komision i posaçëm shqyrtimi ose riprovimi. Nga vizita në institucion, nuk u referuan raste të tilla ankimi, por vetëm shqyrtime dhe sqarime lidhur me vlerësimin në nivelin e komisionit të provimit. Aneks 2.1: Statuti i UBT-së. Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve UBT Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ konfirmon se kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave është hartuar të thellojë njohuritë për mjedisin duke nxitur dhe zhvilluar aftësi profesionale të studentëve në këtë fushë. Kjo kurrikulë ka në përbërje lëndë ku merren njohuri të thelluara si Kimia e mjedisit, Fizika mjedisore e tokës, Hidrobiologji Agroekologji, etj. Të gjitha këto lëndë janë në funksion të formimit të shprehive të veçanta për shumë profesione dhe specialitete si inxhinieri mjedisi, planifikues, projektues terriroresh, menaxher i zonave të mbrojtura, etj. Praktika profesionale e programit të studimit synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve në DAME.</p> <p>Programi thellon dijet, njohuritë, duke synuar jo vetëm thellimin e njohurive por edhe dhënien e informacioneve për zbatimin e tyre në praktikë.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programi të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Shqyrtimi i Planit mësimor konfirmon se Programi i studimit zhvillon aftësi në fushën e Teknologjisë së Informacionit e Shkencave të komunikimit.</p> <p>Këto i japin mundësi studentit të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të punojë në grup, të përdorë Teknologjinë e informacionit dhe të fitojë terminologjinë e duhur mjedisore në Anglisht.</p> <p>Aneks 14: Dosja e plotë e programi të studimit</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pohon se në përfundim të lëndës, stafi akademik bën vlerësimin e nivelit të kompetencave të fituara sipas syllabusit. Njësia organizon rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Ky rishikim bëhet në bazë të ecurisë së studentëve në lëndë për nivelin e kompetencave dhe aftësive të fituara dhe konkluzionet nxirren në analizën vjetore të DAME.</p> <p>Janë rishikuar kreditet, modulet e lëndëve, baza e nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, i literaturës së përdorur, procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e kontrollit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Analiza vjetore e punës në DAME merr në shqyrtim ecurinë e punës dhe rezultatet e fituara për çdo lëndë. Personeli akademik në përfundim të çdo lënde bën përmbledhjen e temave ku studenti duhet të fokusohet për provimin dhe demonstroi raste praktike nga vite të mëparshme. Në këtë mënyrë studentët ndihmohen të fokusohen më mirë në përmbajtjen e programit dhe për testimin e dijeve në përfundim sipas rregullores përkatëse</p> <p>Aneks 6: Rregullore FBM 2017-2018 Aneks 7: Rregullore e studimit DAME MSc Aneks 14: Dosja e plotë e programit të studimit</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>GVJ konfirmon orët e hapura të leksioneve dhe angazhimin e studentëve në praktika laboratorike për përshkrimin dhe informimin e kompetencave të reja dhe zhvillimeve teknologjike.</p>

teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Formimi i studentëve me kompetenca të reja realizohet përmes dhënies së detyrave të kursit në lëndë dhe tematika të ndryshme, ku studenti duhet të punojë individualisht dhe të paraqesë rezultatet e punës së tij në mënyrë individuale apo në grup, sipas specifikimeve të dhëna nga pedagogu i lëndës.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Elementë të novacionit janë referuar gjatë takimeve në institucion edhe përmes përfshirjes në procese kombëtare si psh. projekti i 100 fshatrave turistike, ku studentët ngarkohen me detyra konkrete të planifikimit mjedisor.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Aneks 14: Dosja e plotë e programi të studimit			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	DAME ka përdorur dhe mundësitë e krijuara nga EDE (Ekonomia Didaktike Eksperimentale), e cila ka për qëllim kryesor të realizojë punën kërkimore-shkencore dhe funksionin didaktik dhe eksperimental për pedagogët dhe studentët e universitetit për kryerje të studimeve të ndryshme dhe praktikave profesionale. Sektori i Eksperimentimit dhe Prodhimit Bujqësor ka një sipërfaqe toke nën kulturë prej 130.5 ha. Gjatë takimeve, GVJ u informua se Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e subjekte të tjera, të cilat iu garantojnë studentëve kryerjen me sukses të praktikave profesionale që janë pjesë përbërëse e këtij programi studimi.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Për rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve dhe për të marrë njohuritë e nevojshme ka ndërthurrur shkëmbimet e mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se ndonëse mundësitë e mobilitetit për studentët e Masterit Shkencor janë prezantuar nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, numri i studentëve përfitues ka qenë i vogël.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	GVJ konfirmon se procesi i diplomimit përmbyllet me mbrojtjen e diplomës. DAME në bazë të rregullores ka procedurë të posaçme dhe e paraqet në faqen e UBT dhe stendat e DAME. Në rregulloren e FBM përcaktohen kriteret dhe mënyra e organizimit. Aneks 5: Rregullore e studimeve UBT

	Aneks 6: Rregullore e studimeve në DAME 2017-2018
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	GVJ konfirmon se DAME e realizon mbështetjen për studentët për mbrojtjen e diplomës. Stafii akademik jep udhëzimet e nevojshme dhe materialet e duhura për mbrojtjen e diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Mbrojtja e diplomave realizohet përpara komisionit të posaçëm me anëtarë të departamentit. Ai miratohet nga Dekani. Kryetari i Komisionit është përgjegjësi i departamentit. Kriteret e vlerësimit përfshijnë cilësinë e punimit të shkruar dhe të lidhur, prezantimit prej studentit gjatë mbrojtjes dhe përgjigjet ndaj pyetjeve të komisionit. Mbrojtja e temës është e hapur edhe për studentë dhe të tjerë të interesuar. Aneks 5: Rregullore e studimeve UBT Aneks 6: Rregullore e studimeve në DAME 2017-2018
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Gjatë takimeve me stafin akademik është theksuar se procesi i përgatitjes së diplomës vlerësohet i rëndësishëm dhe merr vëmendjen e duhur. Ai fillon me përzgjedhjen e temës së diplomës për të cilën punohet gjatë semestrit të katërt.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në takimin me drejtuesit e grupeve kërkimore u theksua se studentëve u lihej e hapur alternativa e zgjedhjes së temave të diplomave në fushat ku ata dëshirojnë të vijonë zhvillimin profesional. Në varësi të tematikës së zgjedhur, studentët mbështeten me sugjerime për literaturën shkencore dhe grumbullimin e të dhënave (përfshirë edhe marrjen e mostrave), përpunimin në laborator në rastet kur tema ka karakter praktik.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Gjatë vizitës në Laboratorin Shkencor të Mjedisit, GVJ ju referua se ky laborator shërben edhe për analizimin e mostrave të ndryshme të tokës dhe ujit për temat e diplomave të studentëve. Më pas, puna vijon në nxjerrjen e rezultateve dhe hartimin/shkrimin e temës. Në përfundim të procesit, drejtuesi shkencor e miraton punimin duke e firmosur atë. Në këtë mënyrë studenti ka të drejtën e paraqitjes në komisionin e mbrojtjes së diplomave.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas DVV dhe konfirmimit të marrë gjatë vizitës në institucion, dhe të dhënave të depozituara në Sekretarinë mësimore konfirmohet se vlerësimi bëhet me notë në sistemin me dhjetë nota. Vlerësimi i punimit të diplomës merr parasysh cilësinë e punimit të shkruar dhe të lidhur, prezantimit prej studentit gjatë mbrojtjes dhe përgjigjet ndaj pyetjeve të komisionit.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në rregulloret e institucionit, studenti pajiset me Diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuar nga MASR. Aneks 5: Rregullore e studimeve ne UBT Aneks 15.3: Suplementi i diplomës
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ konfirmon se kopje të dokumentacionit për studimet e kryera mund të tërhiqen nga studentët pranë sekretarisë mësimore brenda kohës së përcaktuar.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Gjithë informacioni për studentët ruhet pranë sekretarisë mësimore dhe mund të tërhiqet prej studentëve të interesuar bazuar në kërkesën e tyre me shkrim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në DVV, dhe vizitës në Institucion, shprehet se: DMBNJ në mënyrë sistematike mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Kjo, bazuar në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Aneksi 11.2 Rregullore e DMBNJ) të Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku bën pjesë edhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit. Gjatë vizitës në institucion GVJ pa me përzgjedhje rastësore dosje të personelit akademik ku ishin të grumbulluara të gjitha informacionet mbi stafin. Dosja e një pedagogu përbante: CV të përditësuar; Diplomë dhe listë notash; Trajnime dhe kualifikime të ndryshme; vendime të Titujve dhe Gradave; Foto; Listë e publikimeve dhe artikujve të botuar. Aneks 11.2: Rregullore e DMBNJ
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Bazuar në Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT (Aneksi 11_1 Rregullore rekrutimi UBT 2018) institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura për rekrutimin e stafit akademik referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet (57, 58,59 dhe 67), si dhe Statutit të UBT (nenet 29, 30 dhe 31). Referuar Rregullores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave (Aneksi 11_2), Neni 6, kjo Drejtori ndjek të gjitha procedurat e plotësimit të strukturës me rekrutime të reja, që nga shpallja publike e vendit të punës

	në Buletinin e APP-së, hartimi i ofertës së punës, etj, kriteret e pranimit, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. DBNJP ndjek edhe procedurat për rekrutimin, kur është e nevojshme, të punonjësve me kontratë të përkohshme (personel akademik, i ftuar dhe jo akademik).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, rezulton se institucioni ka hartuar procedura dhe kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, siç përcaktohet në Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik, Ndhmës dhe Administrativ në UBT. Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave standarde për mënyrën e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ajo përfshin rregulla, kriteret e standarde për rekrutimin e personelit akademik , ndihmës akademik dhe administrativ.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ takoi drejtuesin e kësaj zyre i cili edhe pse për një kohë të shkurtër në këtë detyrë (detyrë që e mbulonte që prej një muaji) na njohu me procedurën që ndiqte kjo Drejtori në lidhje me kriteret e pranimit, ngritjen e komisioneve, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, informacionin përfundimtar dhe vendimin e emërimit. Sipas Zyrës së Burimeve Njerëzore, nevoja për rekrutim të personelit lind në Departament. Përgjegjësi i Departamentit ja transmeton këtë kërkesë Dekanit të Fakultetit i cili më pas e përcjell tek Rektori i UBT. Më pas kjo kërkesë paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Pagave e cila bën shpalljen e vendit vakant në Buletinin e APP. Rregullorja e rekrutimit përcakton shpalljen dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion. Kriteret e përgjithshme përcaktohen nga Senati i UBT-së. Kriteret e veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori (model i kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta jepet në Aneksin 44_14 formati i Publikimit të kriterëve). Sipas afateve kohore të deklaruara, kriterëve të përgjithshme dhe kriterëve specifike në përputhje me modulën apo lëndën për të cilën departamenti ka nevojë për staf të ri, bëhet shpallja e konkursit, duke bërë publike kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, komisionin përzgjedhës, ditën, orën, dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve dhe/ose intervistës me gojë. Aneks 11.1: Rregullore e rekrutimit UBT 2018 Aneks 44.14: Formatit i Publikimit të Kriterëve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht për t	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur (rregulloret e ndryshme dhe vendimet e Senatit apo rektoratit) dhe bisedat e zhvilluara me drejtuesin e Fakultetit dhe të Departamentit, grupet kërkimore-mësimore dhe stafin akademik rezultojnë se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësive të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Të gjithë personelit u janë krijuar mundësi të barabarta për kualifikim shkencor dhe përfshirje në projekte kërkimore shkencore. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, janë lirish të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me Përgjegjës të Departamentit, me GVB por dhe me stafin akademik, rezultoi se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit që mbulon këtë program studimi, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e këtij Departamenti. Nuk kanë munguar pjesëmarrjet e pedagogëve mësimdhënës në konferenca të ndryshme shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet në revista shkencore me faktor impakti apo me ISBN. Nuk ka munguar gjithashtu edhe pjesëmarrja dhe përfshirja e pedagogëve në projekte si Erasmus +; Horizon 2020, IPA. Një pasqyrë e detajuar e lëvizjeve të pedagogëve për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 gjendet në Aneksin 43_6 dhe 43_7.</p> <p>Në DVV paraqitet edhe Raporti i Analizës së Veprimtarisë kërkimore në UBT për vitin 2017. Sipas këtij raporti, hartuar nga një grup pune ku bën pjesë edhe Përgjegjësi i Departamentit të Agromjedisit, treguesit sasiorë për kërkimin shkencor për fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, janë si më poshtë:</p> <p>Artikuj ISI journal – 14 artikuj Artikuj të tjerë në (non-ISI) journal (Jashtë vendit) – 48 artikuj Artikuj të tjerë në (non-ISI) journal (Brenda vendit) – 16 artikuj Punime të paraqitura në konferenca ndërkombëtare – 51 punime Punime të paraqitura në konferenca kombëtare – 7 punime Raporte shkencore (për projekte, studime shkencore, konsulenca etj) – 6 raporte</p> <p>Për sa më sipër, GVJ konstaton se interesimi nga institucioni për kualifikim e vazhdueshëm të personelit është serioz.</p> <p>Aneks 43.6: Lëvizjet e Stafit & Studentëve I Aneks 43.7: Lëvizjet e Stafit & Studentëve II Aneks 38.1: Raporti i Analizës së Veprimtarisë Kërkimore në UBT 2017</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, është hartuar një udhëzues, i cili ndodhet në anekset e DVV (Aneksi 39). Sipas këtij Udhëzuesi, në këtë institucion përveç metodave standarde të mësimdhënies (leksione, seminare, detyra e projekte kursi, praktika profesionale, provime) janë adaptuar edhe disa metoda inovative të mësimdhënies si zhvillimi i orëve të seminarit në mjediset e jashtme të kampusit apo zhvillimi i orëve të praktikave mësimore në subjekte që lidhen me programin e studimit.</p>

	<p>Veç kësaj institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtejshëm të stafit. Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E-learning - që përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimit , e cila zhvillohet me ndihmën e pajisjeve elektronike. Me këto metoda, materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime power-point, audio, video, teste, forume, animacione etj. • Google site - Me anë të këtij aplikacioni mund të mblidhen lehtë dhe shpejt një sërë informacionesh në një site të vetëm. Studentët nëpërmjet google site kanë mundësinë të aksesojnë materialet e leksioneve dhe informacionet e digjitalizuara, të ngarkuara nga pedagogu. • Moduli online “Njohuria mbi informacion” - Studenti mëson se si të gjejë informacionin e duhur që u shërben për të shkruar një detyrë/punë shkencore, duke shfrytëzuar tre llojet e burimeve të informacionit; si ta vlerësojnë atë, duke përdorur filtrat e nevojshëm; dhe si ta përdorin informacionin në mënyrë efektive në dobi të tyre, duke adresuar siç duhet nevojat e detyrës/punës shkencore. • TEEAL - Biblioteka Themelore Elektronike Bujqësore, është një bazë të dhënash me tekste të plotë të artikujve nga më shumë se 450 revista kërkimore, me cilësi të lartë në fushën e bujqësisë dhe në shkencat e lidhura me të. • Sistemi ESSE3 - është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve, nga aplikimi në Universitet, jetës universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Qëllimi kryesor është vënia në punë e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit. <p>Për sa më sipër, GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafet akademike dhe studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Ngarkesa e stafit të angazhuar direkt në këtë program studimi shkon nga 20 orë deri në 275 orë në vit. Ndërkohë duhet theksuar se stafi akademik është njëkohësisht i angazhuar edhe në programe të tjera studimi të ofruara nga institucioni dhe ngarkesa totale e stafit shkon nga 120 orë deri në 401 orë në vit. Pothuajse i gjithë stafi akademik është i mbingarkuar (min 162/60, max 401/140).</p> <p>Nga takimet e realizuara në institucion me drejtuesit dhe stafin akademik pranohet problemi i mbingarkesës, duke theksuar se rekrutimi i stafit të ri është i vështirë sa kohë nuk është stabilizuar numri i studentëve që hyjnë në programet e studimit të ofruara nga ky institucion.</p> <p>Gjithashtu, hapja e programeve të ciklit të tretë të studimit do të ndihmonte në këtë drejtim, pasi doktorantët mund të angazhohen edhe në programin mësimor. Kjo do të siguronte edhe një vazhdimësi në ofrimin cilësor të programeve të studimit po të kemi parasysh se aktualisht pjesa më e madhe e anëtarëve të stafit akademik të departamentit janë me moshë më të madhe se 45 vjeç.</p>

	Aneks 24.2: Të dhëna tabel për stafin akademik MSc 2018-2019.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë dy ditëve të vizitës në Institucion, GVJ pjesë të agjendës së tij, kishte edhe vëzhgimin e ambienteve në funksion të zhvillimit të programit të mësimin, por edhe të ambienteve në funksion të pedagogëve që mbulojnë këtë program studimi. GVJ pati mundësinë të shikonte disa auditorë mësimorë, me kapacitete deri në 60 vende uljeje, të kompletuar me sistemin e kondicionimit, video-projektimi, tabela shkrimi. Sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive, lidhje me internet), të cilat garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të mira të mësimdhënies.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vizitoi edhe godinën në të cilën ndodheshin zyrat e stafit akademik të Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë (DAME), të cilët mbulojnë programin e studimit. Hapësirat ishin të kompletuara, komode, me jo më shumë se 2 pedagogë në çdo zyrë.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Pranë Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë funksionon Laboratori Shkencor i Mjedisit, i cili është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analiza në fushën e tokës, mbetjeve dhe ujërave. Laboratori është në dispozicion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Laboratori siguron kushtet mjedisore të përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për aktivitetin laboratorik të testimit. Laboratori është në pajtueshmëri të plotë me Standardet S SH ISO/IEC17025:2006. Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit. Aneks 14_20: Çertifikata e Akreditimit LAME_2014_2018.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ pohon se Institucioni ka dy salla kompjuterësh të lidhur me internet të cilët janë dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. Nga takimet me stafin akademik dhe studentët nuk rezultoi përdorimi i programeve specifike profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Përdorimi i programeve profesionale (p.sh sistemet e informacionit gjeografik - GIS) kryhet mbi baza të aftësive individuale.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione	UBT ka në strukturën e tij EDE (Ekonomia Didaktike Eksperimentale) e cila ka për qëllim kryesor të realizojë punën kërkimore-shkencore dhe

dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>funksionin didaktik dhe eksperimental për pedagogët dhe studentët e universitetit për kryerjen e studimeve të ndryshme dhe praktikave profesionale. Sektori i Eksperimentimit dhe Prodhimit Bujqësor ka një sipërfaqe toke nën kulturë prej 130.5 ha. Gjate takimeve, GVJ u informua se Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e subjekte të tjera, të cilat iu garantojnë studentëve kryerjen me sukses të praktikave profesionale që janë pjesë përbërëse e këtij programi studimi.</p> <p>Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UBT, GVJ pa edhe mjediset e Bibliotekës Shkencore "Mentor Përmeti". Sipas të dhënave të referuar nga punonjësja e bibliotekës, biblioteka ka një fond prej 2000 librash në gjuhën shqipe dhe të huaja për fusha të ndryshme studimi si dhe 5000 volume periodiku (shqip dhe të huaj). Kjo bibliotekë është e shtrirë në një sipërfaqe prej rreth 1300 m ² dhe përballon nevojat e studentëve dhe stafit akademik për literaturë kërkimi dhe mësimi. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ vizitoi edhe një mjedis tjetër biblioteke e cila është ngritur pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, me kushte moderne me një kapacitet mbi 100 vendesh. Kjo biblioteke ka edhe një sallë me 12 kompjuterë të lidhur me internet nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL (The Essential Electronic Agricultural Library) aplikuar në UBT. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera online pa pagesë (p.sh., Google site; MOODLE, Research4life me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Salla e kompjuterëve shfrytëzohet nga studentet edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Bazuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit, biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime ne revista shkencore. Ky plan përfshihet në projekt buxhetin e institucionit. Projektet e ndryshme ku janë përfshirë punonjësit e institucionit kanë ndihmuar me futjen titujve të rinj të literaturës bashkëkohore.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e hapur nga e hëna në të premte prej orës 8.00 – 16.00. Biblioteka ofron shërbimet dhe kapacitetin e saj pa pagesë e në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin që janë të regjistruar.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit	

ekzistues në mbështetje të programit.	Aneks 3.1: Plani Strategjik i Zhvillimit të UBT-se, 2016-2025.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Aneks 42: Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit Aneks 45: Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentet e paraqitura (Aneksi 9) Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) ka përgjegjësinë e regjistrimit të studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike. ZSS plotëson të gjithë dokumentet individuale certifikuese mbi rezultatet e pjeseshme ose të plota të studimeve dhe ruan dokumentacionin mbi ecurinë e procesit mësimor. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucionit GVJ u njoh me regjistrat e studentëve në format elektronik dhe formë shkresore. Regjistri bazë kishte të dhënat mbi regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit deri në diplomim, të dhëna për diplomën. Regjistri i notave mban të dhëna për vlerësimin e studentëve gjatë vitit. Aneks 9: Rregullore e Sekretarisë mësimore.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, UBT ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën ESSE3. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe dokumentet e stafit akademik, ndihmës e administrativ. Gjatë vizitës në institucion u shqyrtua edhe dokumentacioni mbi personelin akademik, kryesisht mbi realizimin e procesit mësimor të programit në shqyrtim. Link i modulit në shqip: https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al .
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet këtij sistemi i gjithë stafi apo studentët e regjistruar mund të aksesojnë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit si regjistrimin dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	Sistemi lejon aksesimin dhe komunikimin nëpërmjet adresave të postës elektronike.

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.									
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	GVJ testoi sistemin dhe rezultoi që ai garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit mësimor. Drejtuesit e institucionit apo personat e interesuar mund të nxjerrin raportime e të dhëna për procesin mësimor dhe aktivitetin akademik.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Sistemi i menaxhimit të informacionit për momentin është vetëm në gjuhën shqipe. Ndërkohë, faqja e internetit të UBT ofron informacion të hollësishëm për institucionin dhe programet e studimit që ofrohen. http://ubt.edu.al/en_US/								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumenteve të paraqitura në DVV, rezulton se UBT çdo vit paraqet një raport financiar. Gjithashtu, UBT ka përgatitur edhe një plan buxhet afatmesëm për periudhën 2016-2018. Sipas të dhënave financiare për Departamentin e Agromjedisit dhe Ekologjisë rezulton se për 5 vitet e fundit të ardhurat janë më të vogla se shpenzimet. Gati gjysma e të ardhurave sigurohen nga studentët apo laboratorit shkencor. Aneks 49: Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit. Aneks 50: Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit (Tabelë përmbledhëse).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjedisëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të	Në hartimin e buxhetit afatmesëm UBT ka theksuar se drejtimet kryesore të buxhetit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e numrit të stafit akademik; • Mbështetje e kualifikimit të stafit brenda e jashtë vendit; • Përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencorë; • Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor nëpërmjet abonimit në revista shkencore dhe funksionimi i bibliotekës online; • Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, dhe • Mbështetja e pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare. Përveç fondeve buxhetore, që mbulojnë kryesisht shpenzimet për paga dhe investime kapitale, UBT synon të rrisë të ardhurat nga njësitë në

studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	varësi të UBT (Laboratori shkencor, Ekonomia Didaktike eksperimentale, etj). Këto të ardhura plotësojnë shpenzimet për stafin si dhe nevojat e tjera të institucionit në mbështetje të kërkimit shkencor.			
	Aneks 3: Plani strategjik për zhvillimin e programit (në nivel akademik, financiar, burimesh njerëzore etj).			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Pranë UBT funksionon Zyra e Auditimit të Brendshëm. Në dokumentet e paraqitura në DVV nuk ka ndonjë raport auditimi të viteve të fundit. Raporti financiar i përmendur me sipër përmban të dhëna të hollësishme financiare mbi kostot dhe të ardhurat përfshirë tarifat e shkollimit dhe burimet e tjera financiare.			
	Aneks 49: Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në dokumentet e paraqitura në DVV, është vetëm raporti financiar për vitin 2017. Tabela përmbledhëse e të dhënave nga plani i financimit të programit të studimit paraqet të ardhurat dhe shpenzimet kryesore për 5 vitet e fundit. Plani strategjik dhe buxheti afatmesëm 2016-2018 përmendin aktivitete për përmirësimin dhe diversifikimin e të ardhurave dytësore në UBT.			
	Aneks 50: Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit (Tabelë përmbledhëse).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Siç theksuam dhe më sipër, nga raporti i të ardhurave me shpenzimet për 5 vitet e fundit duket se institucioni ka qëndrueshmërinë e nevojshme financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Sidoqoftë, në DVV, theksohet se qëndrueshmëria financiare është një pikë e dobët. Nga diskutimet me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, u sqarua se kjo lidhet me nevojën për shtimin e stafit dhe reduktimin e ngarkesës, çka garanton përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe më shumë mundësi për kërkim shkencor. Numri jo i stabilizuar i studenteve në ciklet e ndryshme të studimit ndikon në qëndrueshmërinë financiare afatgjatë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për zbatimin e politikave dhe përcaktimin e procedurave për pranimin, përparimin, vlerësimin, transferimin dhe diplomimin e studentëve për gjatë gjithë ciklit akademik.</p> <p>Në UBT funksionon Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, e cila ka në varësi Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA) pranë të cilës është ngritur Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS). ZKS informon dhe orienton studentët për pranimet në programet e studimit dhe ndjek ecurinë e studenteve deri në diplomim.</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve UBT, Kreu I, Neni 1,2,3, 4, 5. Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018, Kreu I, Neni 1,2,3,4. Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018, Kreu V, Neni 33 deri 38. Aneks 9.2: Rregullore e Sekretarisë mësimore, Neni 14. Aneks 13.2: Manuali i Cilësisë, Pjesa VI, pika 6.1. Aneks 13.4: Rregullorja mbi “Organizimin dhe funksionimin e degës së informimit, orientimit dhe karrierës së Studentëve”. Aneks 46.1: Manual Regjistrimi.</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregulloret e përmendura me sipër garantojnë akses dhe ecuri të barabartë në programet e studimit për të gjithë studentët bazuar vetëm në rezultatet e tyre akademike. Rregulloret e shqyrtuara nuk përmbajnë kritere diskriminuese apo përjashtuese për grupe të caktuara studentësh. ZKS është e hapur dhe ofron shërbimet e veta për të gjithë studentët. Studentët në mënyrë të barabartë kanë akses në informacionet lidhur me programin e studimit si nëpërmjet faqes së internetit të UBT ashtu edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit (ESSE3). Gjatë takimit me studentët, ata u shprehen të kënaqur me mënyrat e ofrimit të informacionit dhe shërbimeve në ndihmë të tyre.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimiit dhe procedurat e avancimit në programin e studimit bazohen vetëm në rezultatet akademike dhe plotësimin e kërkesave të procesit mësimor (pjesëmarrje në seminare, realizimi i detyrave e projekteve të kursit). Kandidatët për studentë informohen nga ZKS nëpërmjet broshurave, takimeve apo internetit mbi kriteret dhe procedurat e pranimiit, përmbajtjen e programit të studimit dhe mundësitë për punësim apo karriere akademike. Metodatat e vlerësimit të dijeve bëhen publike nga pedagogët përkatës në faqen e internetit. Studentët gjatë takimit u shprehen se informacioni i ofruar është i mjaftueshëm dhe i dobishëm.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV si dhe nga vizita në institucion, rezulton se institucioni ka hartuar kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve që pranohen në ciklin e dytë të studimeve. Këto kritere bazohen në cilësinë e rezultateve akademike (nota mesatare) dhe lidhjen dhe rëndësinë e studimeve të ciklit të parë me programin e

	<p>ofruar. Çdo vit akademik, institucioni përcakton kuota pranimi në programin e studimit në varësi të kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore për realizimin me cilësi të programit të studimit. Këto kritere publikohen si në faqen e internetit të UBT ashtu edhe në broshura divulgative që përgatiten për promovimin e programit të studimit.</p> <p>Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve UBT. Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018. Aneks 13.2: Manuali i Cilësisë. Aneks 13.4: Rregullore e Zyrës/Njësisë së Monitorimit të Kurrikulës, Neni 16, pikat 15-20. Aneks 14: Dosje e plotë e programit të studimit në Inxhinieri Agromjedisi Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Agromjedisi. Aneks 14.5: Kriteret e pranimit në FBM. Aneks 47.1: Të dhëna zyrtare nga faqja e internetit. Aneks 51.3: Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>UBT para fillimit të çdo viti shkollor përgatit materiale promovuese për programet e studimit qe ofron të cilat shpërndahen tek studentët që ndjekin programet Bsc pranë UBT, por jo vetëm pranë këtij Universiteti. ZKS zhvillon takime informuese me studentët, takime të cilat janë më shumë orientuese duke marrë në konsideratë edhe dëshirat dhe synimet që kanë këta studentë të Bsc për të ardhmen e tyre. Në këto takime, Studentëve ju komunikohen kriteret e përgjithshme si dhe kriteret specifike të cilat janë të përcaktuar edhe në Rregulloren e programit të studimit, neni 8.</p> <p>Përfaqësuesi i ZKS informoi GVJ se Rektori i UBT dhe Dekani i FBM promovojnë programet e studimit edhe nëpër rrethe, aty ku ka Institucione të Arsimit të Lartë. Gjatë gjithë vitit ZKS mirëpret dhe udhëzon të interesuarit për tu pranuar në programet e studimit të ofruara nga UBT. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik (detyrat e kursit, punët laboratorike, detyrime të tjera, provimet), njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesëshme, procedurat e vlerësimit të dijeve, apo punimet e diplomës. Sistemi garanton njoftimin e studentëve nëpërmjet e-mailit. Gjithashtu, pedagogët në faqet</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e</p>	

procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkt japin informacion të hollësishëm për studentët për lëndët e tyre. ZKS ndihmon studentët të orientohen në gjetjen e informacionit të nevojshëm në mënyrën më të përshtatshme.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.				
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	GVJ ju komunikua se UBT para fillimit të çdo viti shkollor përgatit materiale promovuese për programet e studimit që ofron të cilat shpërndahen jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe. Gjatë gjithë vitit ZKS mirëpret dhe udhëzon të interesuarit për tu pranuar jo vetëm në këtë program studimi, por edhe në programet e studimit të ofruara nga UBT. Të gjitha informacionet publikohen edhe në faqen e internetit të UBT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Zyrat e Sekretarisë dhe ZSK informojnë studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve apo veprimtarive formuese. Të gjitha rregulloret përkatëse janë të publikuara online. Gjithashtu studentët informohen edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit apo faqeve personale të pedagogëve në internet.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve UBT. Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018. Aneks 7.1: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Inxhinieri Agromjedisi. Aneks 12.5: Rregullore e zyrës/njesisë së këshillimit dhe karrierës. Aneks 47.1: Të dhëna nga faqja zyrtare e web e UBT-së.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ ju komunikua se Qendra e Karrierës dhe Alumni organizon çdo vit në UBT panairin e karrierës së Studentëve, në të cilin ftohen të marrin pjesë institucione shtetërore dhe ndërmarrje private të cilat mund të ofrojnë punësim për studentët. Gjithashtu, QKA ofron këshillim dhe orientim në tregun e punës për studentët e interesuar. UBT dhe FBT kanë marrëveshje me një sërë institucionesh e entesh private e shtetërore për të nxitur

	punësimin e studentëve. Pedagogët e modulit menaxhim karriere ofrojnë orientim të vazhdueshëm për studentët në tregun e punës. Ndërkohë edhe Përgjegjësi i Departamentit në takimet e tij të rregullta me studentët orienton edhe mbi mundësitë e punësimit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjate takimit me studentet rezultoi se ata merrnin informacion te detajuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën direkt nga pedagogët përkatës apo nëpërmjet faqes së tyre të internetit. Po ashtu, sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit dhe Zyrat e Sekretarisë japin informacionin e nevojshëm sipas kërkesave të studentëve duke shpërndarë edhe njoftime me e-mail.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.				
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Siç kemi theksuar edhe me sipër, sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) administron gjithë informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin mësimor të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Ne zyrën e sekretarisë mësimore GVJ kontrolloi regjistrat e studentëve të programit të studimit në shqyrtim ku janë regjistruar të gjithë studentët e regjistruar dhe të diplomuar ndër vite, konkretisht: Në vitin akademik 2014-2015 rezultojnë të regjistruar 30 studentë, nga të cilët 1 student është i larguar. Në vitin akademik 2015-2016 rezultojnë të regjistruar 30 studentë. Në vitin akademik 2016-2017 rezultojnë të regjistruar 23 studentë. Në vitin akademik 2017-2018 rezultojnë të regjistruar 33 studentë, 3 prej të cilëve janë rifillim studimesh. Në këtë vit vetëm 1 student është i pa matrikulluar. Në vitin akademik 2018-2019 rezultojnë të regjistruar 30 studentë, 1 student në rifillim studimesh. Gjithashtu në regjistër shënohen edhe tërheqjet apo largimet para përfundimit të studimeve (konstatohet vetëm një rast largimi në këtë program studimi në vitin 2014-2015).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Aneks 27.7: Studentë MSc 2014-2019.

	Aneks 28.2: Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, tërheqjet si dhe largimet para përfundimit të programit.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Ne sekretarinë mësimore u panë edhe regjistrat notave të studentëve sipas lëndëve të programit të studimit, të dhëna për temat e diplomave dhe rezultatet e diplomimit të studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi. Aneks 27.8: UBT Diplomime 2013-2019. Aneks 27.10: UBT Mesatare Studentëve pas Diplomimit			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit përmban edhe të dhënat statistikore të studentëve. Këto të dhëna janë lehtësisht të aksesueshme për personat e autorizuar e të regjistruar në sistem. Këta persona përdorin emër përdoruesi e fjalëkalim të autorizuar për të aksesuar të dhënat.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Sekretaria mësimore, bazuar në të dhënat e administruara, harton raporte statistikore sipas nevojave të fakultetit apo universitetit përfshirë cilësinë e studentëve që mbarojnë studimet. Zyra e karrierës përmbledh të dhënat mbi punësimin e studentëve që kanë mbaruar programin e studimit dhe mundohet të ndjekë ecurinë e karrierës së tyre për aq sa është e mundur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në rregulloret e paraqitura nga institucioni në DVV sanksionohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të UBT. Gjatë takimit me studentët ata theksuan se kanë përfaqësuesin e tyre në Senatin e UBT dhe komisionet e ndryshme të FBM (Komisioni i Etikës, Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të studimit dhe Kërkimit Shkencor). Studentët u shprehën se përfaqësuesit e tyre arrijnë të përcjellin informacionin nga lart poshtë dhe shqetësimet e tyre nga poshtë lart. Në UBT funksionojnë edhe Këshillat studentorë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Aneks 2.1: Statuti i UBT-së, Kreu III, neni 5, pika 5; neni 16, pika 5, 6 dhe 7. Aneks 5.1: Rregullorja e studimeve UBT, Kreu IX/neni 83. Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018, Kreu II, Neni 10, pika 4, gërma a dhe b; pika 5.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të	Programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe garanton një shpërndarje pothuajse uniforme

<p>mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>të ngarkesës në semestra të ndryshëm gjatë ciklit të studimit. Procedurat e përparimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme janë të hapura e të njohura nga të gjithë studentët. Sipas studentëve ngarkesa e lëndëve është në përpjesëtim të drejtë me numrin e krediteve. Studentët nuk paraqitën ndonjë ankesë për procedura burokratike e të tej zgjatura.</p> <p>Aneks 14.8: Plan-Ngarkesa 2019-2019 MSc në dosjen e plotë të programit të studimit me elementët përbërës.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Për të garantuar përfshirjen e opinionit të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit, institucioni kryen anketime të rregullta të studentëve dhe mundohet të reflektojë sugjerimet e tyre. Nëpërmjet këtyre anketimeve studentët shprehen edhe mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, nuk na u paraqit një kanal formal ankimi në dispozicion të studentëve. Sidoqoftë, studentet u shprehen se arrijnë ti adresojnë shqetësimet e tyre direkt me pedagogët apo me drejtuesin e departamentit nëse është e nevojshme.</p> <p>Aneks 40.6: Pyetësor i Studentëve. Aneks 40.7: Analiza e Rezultateve të Anketimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Nga dokumentet e paraqitura në DVV dhe nga takimet me stafin akademik rezulton një pjesëmarrje e kënaqshme e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Sipas një raporti i cili gjendet në DVV, gjatë dy viteve të fundit, dhjetë prej profesorëve të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi kanë qenë udhëheqës në disa tema doktoratash të mbrojtura (minimalisht 2 tema dhe maksimalisht 4 tema). Gjithashtu është paraqitur një listë me publikimet e stafit akademik të kategorisë “Profesor”, publikime/abstract book/referime etj, të konsiderueshme në numër.</p> <p>Aneks 20.2: CV e Stafit Akademik. Aneks 43.1: Të dhëna të aktiviteteve të DAME për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 2 vitet e fundit (2016-2018). Aneks 43.4: Lista e konferencave UBT 2013-2016. Aneks 43.9: Raporti i Analizës së Veprimtarisë Kërkimore dhe Shkencore për vitet 2017-2018.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Sipas dokumenteve të paraqitura në DVV, UBT ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi (44) me institucione kërkimore shkencore e të arsimit të lartë kombëtare e ndërkombëtare. Këto marrëveshje garantojnë përfshirjen e stafit në aktivitete të mirëfillta kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Aneks 4.1: Plan Strategjia e Zhvillimit të UBT-së 2016-2025, Seksioni 6 faqe, 44-49.</p> <p>Aneks 32.6: Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) me Institucionet Homologe Brenda dhe/ose Jashtë Vendit.</p>			
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i nxit studentët e programit Master Shkencor të përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore e si rrjedhim të shkruajnë e publikojnë punime shkencore, kryesisht gjatë realizimit të diplomës (mikrotezës).</p> <p>Pranë FBM funksionon edhe Forumi Studentor për Mjedisin dhe Bujqësinë, i cili nxit pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore. Studentët janë përfshirë edhe në programin Erasmus+.</p> <p>Aneks 43: Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.</p> <p>Aneks 56.5: Takimi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit me Forumin Studentor për Mjedisin dhe Bujqësinë.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Parimisht institucioni mbështet publikimin në revista shkencore të stafit akademik, por mungesa e mbështetjes financiare e bën të pamundur pagesën e kuotave të kërkuara për botim. Pedagogët detyrohen të paguajnë vetë tarifat e botimit në rast se duan të botojnë në revista të njohura e me faktor impakti.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Personeli akademik nxit pjesëmarrjen e studentëve në kërkimin shkencor dhe disa nga temat e trajtuara në këtë program studimi janë inovative përfshirë modelimin e trajtimit të mbetjeve apo rehabilitimit të zonave problematike e të ndotura. Sidoqoftë, do të ndihmonte në këtë drejtim përdorimi më i gjerë i programeve specifike të teknologjisë së informacionit (p.sh., GIS).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Prezenca e laboratorit shkencor është një ndihmë e madhe për këtë program studimi. Personeli akademik nxit dhe ndihmon studentët të kryejnë vetë analizat e nevojshme në laborator. Departamenti ka krijuar një praktikë të përdorimit të laboratorit nga studentët me turne javore në grupe treshe. Kjo ndihmon që studentët të fitojnë aftësi praktike në kryerjen e analizave të ndryshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">✓</p>

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV, por edhe në takimet e ndryshme të realizuar gjatë vizitës, GVJ-së Ju komunikua se UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera publike e jo publike si dhe me institucione kërkimore kombëtare. Stafi i UBT bashkëpunon në kuadër të projekteve të ndryshme (IPA, Erasmus, Horizon 2020). Gjatë takimit me stafin dhe studentët u theksua se bashkëpunimi me institucionet kërkimore është me interes për zhvillimin e kërkimit shkencor.</p> <p>Konkretisht UBT aktualisht ka 44 marrëveshje aktive bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë nga vende të ndryshme në Evropë, Azi, Kosovë dhe Shqipëri. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është zgjerimi dhe forcimi i bashkëpunimit shkencor dhe arsimor. Ndërsa disa prej objektivave janë : Shkëmbimi i personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; Shkëmbimin e studentëve; Shkëmbimin e stafit administrativ; Nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore – shkencore; Organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj. Shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore, etj.</p> <p>Aneks 32.6: Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) me Institucionet Homologe Brenda dhe/ose Jashtë Vendlit.</p> <p>Aneks 28.3/4: Lëvizjet e stafit dhe studentëve UBT.</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Personeli akademik i nxit studentet të përfshihen në aktivitete kërkimore duke shfrytëzuar edhe laboratorin shkencor pranë departamentit. Një pjesë e mirë e temave të diplomës përfshijnë kryerjen e analizave në laborator, çka ndihmon studentët të fitojnë shprehitë e duhura për vazhdimin e kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik me studentët u theksua se pedagogët mundohen të përfshijnë studentët në projekte kërkimore kryesisht gjatë realizimit të temave të diplomës. Ka disa artikuj të botuar ku studentët janë bashkautorë.</p> <p>Aneks 43.1: Të dhëna të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 2 vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura në DVV, UBT ka politika që mbështesin afrimin e kërkuesve të huaj në institucion.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Nga takimet me drejtuesit e departamentit por edhe në takimin me studentët rezultoi se institucioni mbështet lëvizjen e studentëve që angazhohen në veprimtari kërkimore ndërkombëtare. Në grupin e studentëve që u takuan me GVJ, ishte një student që kishte përfunduar një semestër studimi jashtë vendlit. Sidoqoftë, studentët përgjithësisht nuk ishin shumë entuziaste për tu përfshirë në aktivitete të tilla.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik</p>	<p>UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete ndërkombëtare, të cilat mbështesin lëvizjet e stafit akademik dhe studentëve. Nga dokumentet e paraqitura rezultoi se ndër vite ka pasur një numër</p>

dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	studentësh apo kërkuesish të huaj që kanë qëndruar për afate të ndryshme kohore pranë UBT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓	

Standardi V.8				
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Studimeve dhe Studenteve (ZSS) është në shërbim të studentëve dhe ofron informacione të nevojshme lidhur me ecurinë e tyre në procesin mësimor.			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Siç kemi theksuar edhe me sipër, në UBT funksionon sistemi i menaxhimit të informacionit ESSE3, i cili siguron informacionin e nevojshëm për studentët. Gjithashtu, pedagogët dhe drejtuesit e departamentit ofrojnë mbështetje dhe udhëzime për studentët sipas nevojave të tyre.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Qendra e Karrierës dhe Alumni siguron mbështetje për studentët lidhur me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe orientime për karrierën e mëtejshme.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Sipas të dhënave të referuara gjatë takimit me QKA, kjo zyrë mundohet të mbledhë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e diplomimit të studentëve. Rezulton se të dhëna të pakta mblidhen gjatë vitit të parë pas përfundimit të studimeve dhe më pas kontaktet ndërpriten. Nga statistikat e mblidhura rezulton se një pjesë e mirë e të diplomuarve janë punësuar jashtë profilit (call center, menaxher shitjesh).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Statuti i UBT dhe një sërë Rregulloresh të miratuara përcaktojnë politikat dhe strukturat për Sigurimin e brendshëm të cilësisë. Pranë senatit të UBT funksionon Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, i cili harton politikat dhe procedurat për garantimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Aneks 2.1: Statuti i UBT-së, Kreu V, neni 26; Njësitë Ndihmëse në Funksion të Procesit Mësimor-Shkencor; Kreu IX, Neni 69: Sigurimi i brendshëm i cilësisë.</p> <p>Aneks 4: Plani Strategjik i UBT-së (2016-2025), pika 5.2. Sigurimi i cilësisë. Aneksi 5.1. Rregullorja e studimeve UBT, Kreu XIII, Vlerësimi i cilësisë, neni 90, pika a,b,c,d.</p> <p>Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018, Kreu II, neni 10; Kreu XII, Vlerësimi i cilësisë, neni 89, pika 1,2,3,4.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të UBT. Ajo bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Pyetësori për studentët që realizohet çdo fund semestri është një nga instrumentet e përdorura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Aneks 8: Rregullore DZHKKVI & DITNJ UBT 2019</p> <p>Aneks 8.2: Manuali i Cilesise UBT</p> <p>Aneks 40: Pyetësori i studentëve, rezultatet e anketimit.</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>UBT ka përfunduar akreditimin institucional. Programi i studimit “Master i Shkencave“ në Inxhinieri Agromjedisi po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.</p> <p>Aneks 5.11: Dokumenti i Akreditimit të UBT-së.</p>
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së	<p>Siç kemi përmendur me sipër institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të</p>

<p>programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>realizuar në të gjitha njësitë bazë. Ai vlerëson preferencën e stafit akademik, gjendjen dhe cilësinë e infrastrukturave e pajisjeve, funksionimin e zyrave mbështetëse (ZSS, QKA), financimin e qëndrueshëm të programeve të studimit, ngarkesën e stafit dhe nevojat për rekrutime, etj. Raporti i hartuar në bazë departamenti, fakulteti e universiteti, garanton përfshirjen e gjithë njësive përbërëse dhe aktorëve të brendshëm.</p> <p>Aneks 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional pranë të cilit funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësia e posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të studimit dhe Kërkimit Shkencor në nivel universiteti i raporton senatit mbi vlerësimin dhe rishikimin e programeve të studimit.</p> <p>Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në fakultet shqyrton paraprakisht propozimet për ndryshimin/rishikimin e kurrikulave dhe programit mësimor. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e kurrikulave.</p> <p>Aneks 52.1: Procedurë për ndryshimin e kurrikulës. Aneks 52.2: Vendim për komisionet e ndryshimit të kurrikules.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni përdor procedura formale e të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit. Procedura fillon me propozimin e departamentit, shqyrtimin nga komisioni i posaçëm, kalimin nëpërmjet dekanit dhe rektorit në Senatit e UBT për miratim.</p> <p>Sipas Rregullores së studimeve të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Rishikimi i programit të studimit dhe ndryshimet në kurrikulë kryhen sipas procedurës së përcaktuar për ndryshimin e kurrikulës.</p>

	Aneks 6.1: Rregullore e FBM 2017 – 2018, Kreu XII, neni 91. Aneks 52.1: Procedura për ndryshimin e kurrikulës. Aneks 52.2: Vendim për komisionet e ndryshimit të kurrikulës.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Instrumentet e përdorur për vlerësimin e cilësisë përfshijnë anketimet dhe pyetësorët për studentët, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësim të detyrave dhe provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve apo praktikës profesionale, kontrolli i plotësimit të ngarkesës mësimore e akademike.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet periodike të vlerësimit i paraqiten Dekanit, Rektorit dhe diskutohen në Senatën e UBT, i cili miraton planin e masave për adresimin e problemeve të evidentuara. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor publikon raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Aneks 38: Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, të hartuara në nivel departamenti dhe fakulteti, përfshijnë rezultatet e vlerësimit dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Raportet janë të periodike dhe të përvitshme dhe në to publikohen rezultatet e vlerësimit. Nga takimet me drejtuesit e departamentit u theksua se ndër vite ka pasur një sërë masash që janë realizuar në plotësim të gjetjeve të raporteve të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë ka vlerësuar në mënyrë periodike programin e studimit. Rezultat e vetëvlerësimit të brendshëm lidhur me cilësinë dhe ecurinë e procesit mësimor janë përfshirë në Dosjen e Vetëvlerësimit për Akreditim. Aneksi 37.1. Raport i Vetëvlerësimit të Brendshëm të FBM, 2014. Vendim nr.1, datë 19.01.2015 “Për miratimin e Raportit të VV të FBM”.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me	Siç e kemi përmendur edhe më sipër, institucioni ka përdorur metoda të ndryshme për vlerësimin e cilësisë ku përfshihen metodat e drejtpërdrejta si inspektimet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, vlerësim paralel të

natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	detyrave dhe provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve apo praktikës profesionale dhe metoda të tërthorta si kontrolli i plotësimit të ngarkesës mësimore e akademike, anketimet dhe pyetësorët për studentët, formularin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, diskutime me institucionet partnere.							
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.								
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program								
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
				✓				

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentet e paraqitura në DVV, rezulton se institucioni parashikon përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e sigurimit të cilësisë. Për këtë qellim DAME ka realizuar një numër të madh takimesh e diskutimesh (102 takime) me pjesëmarrje të gjerë ku janë diskutuar probleme të cilësisë së programit të studimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Manuali i cilësisë dhe rregulloret e funksionimit të Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e gjithë strukturave (stafi akademik e ndihmës i departamentit, fakulteti, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, komisionet e posaçme) apo individëve (shefi i departamentit, dekani, rektori) që marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përfshirë edhe studentët.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregulloret e sipërpërmendura garantojnë përfshirjen e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentët) pa dallime e diskriminime dhe në respekt të integritetit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë kryhet nëpërmjet konferencave e takimeve të organizuara në nivel fakulteti apo universiteti. DVV nuk ka të dhëna sasiore (listë personash të ftuar) për përfshirjen e aktorëve të jashtëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			✓	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Të gjitha dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë (manuale, rregullore, vendime) në UBT janë bërë publike nëpërmjet publikimit në faqen e UBT apo afishimit në mjediset e UBT. Janë të aksesueshme dhe GVJ pa disa prej tyre gjatë vizitës. Po ashtu edhe aktivitetet që lidhen me sigurimin e cilësisë njoftohen si më sipër. Studentët, stafi akademik dhe ndihmës kanë mundësinë të marrin gjithë informacionin e duhur mbi këto procese.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë</p>	<p>Edhe raportet e vlerësimit janë bërë publike sipas përcaktimeve në rregullore duke respektuar etikën akademike dhe përcaktimet ligjore për të</p>

dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	dhënat personale. Raportet janë diskutuar në takime e mbledhje të hapura me pjesëmarrjen e stafit akademik, ndihmës dhe studentëve.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vlerësimit shoqërohen me rekomandime dhe propozime masash për adresimin e çështjeve të ngritura dhe përmirësimin e cilësisë të cilat diskutohen dhe miratohen nga senati i universitetit. Aneks 34.16: Program Masash për Mirëfillimin & Mirëvijimin e Vitit Akademik 2018-2019 UBT.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas informacioneve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, një pjesë e mirë e masave të parashikuara në raportet e vlerësimit ndër vite janë realizuar duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit ka organizuar herë pas here aktivitete si me stafin akademik e ndihmës ashtu edhe me studentët për ti informuar dhe ndërgjegjësuar ata lidhur me procesin dhe rezultatet e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
VLERËSIMI TËRËSOR				✓